

Ishte e natyrshme që pushtuesit gjermanë dhe tradhtarët të mos pajtoheshin me këtë gjendje, që ata të vinin të tëra forcat për ta ndryshuar atë në dobi të tyre, duke goditur pa mëshirë Partinë Komuniste dhe UNÇSH.

Komiteti Qendror i porosiste organizatat e partisë të mos deheshin aspak nga sukseset, ta shikonin me sy objektiv e ta kuptonin drejt gjendjen, të kishin mendjen të mos ziheshin në befasi, të përgatiteshin vetë, të përgatisnin partizanët dhe gjithë popullin për të përballuar vështirësitë e mëdha që qëndronin përpara. Mbi të gjitha kërkohej të ishte e çeliktë Partia. «Barra që rëndon mbi supet e Partisë sonë është jashtëzakonisht e rëndë dhe për ta ngritur këtë barrë e për të dalë matanë fitimtarë, duhet të kemi kockën e kurrizit të shëndoshë, duhet të kemi Partinë tonë të organizuar e të fortë, duhet t'i kemi shokët në lartësinë e duhur politike dhe ushtarake, që të mundin në këto momente e situata të vështira e decizive të përballin çdo të papritur dhe të orientohen pa u gabuar»<sup>1</sup>.

## 7. PKSH ORGANIZATORE E LUFTËS HEROIKE TË POPULLIT SHQIPTAR PËR ASGJËSIMIN E PLANEVE TË ARMIKUT NË DIMRIN 1943-1944

Për të asgjësuar Partinë Komuniste, Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe forcën e tyre të armatosur — Ushtrinë Nacionalçlirimtare, pushtuesit gjermanë vendosën të organizonin me ndihmën e tradhtarëve një mësymje ushtarake të përgjithshme.

**Dështimi i mësymjes  
së përgjithshme armike  
të dimrit**

Në këtë mësymje komanda gjermane përdori drejtpërdrejt katër divizione dhe disa mijëra ballistë e zogistë, gjith-

sej rreth 45 mijë veta.

UNÇSH kishte në këtë kohë rreth 20 mijë luftëtarë. Por duke ditur se kundërshtar kishin gjithë popullin e jo vetëm

---

<sup>1</sup> Direktiva e KQ të PKSH, 3 nëntor 1943. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, f. 231.

partizanët, pushtuesit hitlerianë e quanin të pamjaftueshme numrin e forcave të tyre për të zhvilluar mësymjen e përgjithshme me anë të një operacioni të vetëm e të menjëherëshëm. Ata gjetën si rrugë më të përshtatshme kryerjen e një vargu operacionesh, njëri pas tjetrit, në zona të ndryshme të vendit për të asgjësuar Luftën Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar pjesë-pjesë.

I pari i këtij vargu operacionesh u krye në Pezë në nëntor 1943. Pas Pezës, armiqtë ndërmorën operacione në Dibër e në Mallakastër (po në nëntor), në Luginën e Shushicës dhe në zonën Çermenikë—Shëngjergj—Martanesh (dhjetor), në zonën Korçë—Berat (janar 1944) dhe në qarqet e Vlorës e të Gjirokastrës (janar-shkurt). Mësymja e përgjithshme armike u mbyll me operacionin në Malësinë e Gjakovës (në shkurt).

Zona ku zhvillohej operacioni sulmohej nga disa drejtime njëherësh në formë bashkëqendrore me trupa disa herë më të mëdha se forcat partizane në atë zonë.

Njëkohësisht armiqtë kryen operacione edhe në qytetet kryesore të vendit, në Vlorë, në Durrës, në Elbasan, në Shkodër, në Korçë, në Tiranë etj. që ndodheshin të pushtuara. Me operacione të posaçme pushtuan qytetet e Pogradecit, të Beratit, të Peshkopisë, të Dibrës së Madhe, të Gjirokastrës etj., që genë çliruar në ditët pas kapitullimit të Italisë fashiste.

Kudo trupat armike ndeshën në qëndresën heroike të partizanëve e të popullit. Repartet e njësitë e UNÇSH, ndonëse në rrethana jashtëzakonisht të vështira, përballë një kundërshtari tri-katër herë më të madh në numër e në mënyrë të pakrahasueshme epror në teknikë luftarake, nuk e lejuan në asnjë rast atë të shkelte zonat e lira pa luftime të ashpra. Shumica dërrmuese e brigadave, e grupeve dhe e batalioneve partizane e territoriale qëndruan kompakte, ruajtën aftësinë e gatishmërinë luftarake, manovruan me shkathësi duke dalë jashtë rrethimit në krahë e në shpinë të armiqve, duke u dhënë atyre goditje dërrmuese të befashme e duke i detyruar të tërhiqeshin.

Pasoja më të rënda për Ushtrinë Nacionalçlirimtare mësymja e përgjithshme armike e dimrit 1943-1944 solli në Shqipërinë e Mesme e të Veriut. Trupat hitleriane me bandaç reacionare u shkaktuan dëme të mëdha batalioneve të qarkut të Elbasanit, të qarkut të Dibrës, të krahinës së Krujës, të krahinës së Matit, të rrethit të Tiranës, Brigadës II, Brigadës III. Me-

gjithatë, partizanët në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut nuk u asgjësuan. Pas operacionit, ata ishin të detyruar të veprojnë në formacione të vogla në zonat e pushtuara ose të bllokuara nga armiqtë. Grupi i Pezës, me gjithë humbjet që pësoi, i ruajti forcat e veta kryesore, përballoi me trimëri pesë operacione gjermano-tradhtarë, duke e bërë zonën e vet të vepri-meve një kështjellë të pamposhtur.

Një gjendje shumë e rrezikshme u krijua për udhëheqjen e Komitetit Qendror dhe të Shtabit të Përgjithshëm me shokun Enver Hoxha, që mbeti e bllokuar nga armiqtë në zonën Çermenikë—Shëngjergj—Martanesh. Nazistët, ballistët e zogistët nuk lanë mjet dhe mënyrë pa përdorur për të zbuluar dhe për të asgjësuar udhëheqjen e Luftës Nacionalçlirimtare. Por ata nuk mundën. Shumë fshatarë i dinin bazat ku strehoheshin ajo, por asnjëri nuk u frikësua nga kërcënimet e armiqve dhe nuk e tradhtoi Partinë Komuniste dhe Shtabin e Përgjithshëm. Udhëheqësit e Partisë e të popullit, duke përballuar me heroizëm e gjakftohtësi vështirësitë e jashtëzakonshme me ndihmën e fshatarëve, dolën nga rrethimi pa pësuar dëme.

Pushtuesit gjermanë e shoqëruan mësymjen e tyre të madhe me një terror që nuk ishte parë tjetër herë në Shqipëri. Fshatra të tëra i grabitën dhe i bënë shkrumb e hi. Mijëra burra, gra, pleq e fëmijë i pushkatuan, i vranë, i dogjën të gjallë, i burgosën dhe i dërguan në kampet e shfarosjes. Të gjitha qytetet shqiptare u kthyen në të vërtetë në fusha për-qendrimi. Nazistët gjermanë, xhandarët e ballistët në çdo kohë të ditës e të natës thyenin dyert e hynin nëpër shtëpi, shkatërronin, plaçkitnin ç'të mundnin, rrëmbenin me forcë të rinj e të reja, gra e pleq, i rrihnin, i vrisnin pa gjyq dhe i hidhnin nëpër rrugë e nëpër hendeqe. Kufoma partizanësh të vrarë, të kapur ose të nxjerrë nga varri, i ngarkonin në kafshë dhe i shëtisnin nëpër rrugët e qyteteve ose i ekspozonin nëpër sheshet e pazarit. Ditën e masakrës së madhe të 4 shkurtit në Tiranë armiqtë shkruanin në shtypin e tyre: «Gjaku është një shërim rrënjësor për të infektuemit. Gjaku duhet të rrjedhë rrëke nëpër rrugët e Tiranës, nëse kërkojmë me rivendosë qetësinë. Një ditë terrori siguron dhjetë vjet qetësi». Por terrori kundër popullit shqiptar nuk u siguroi asnjë minutë qetësi xhelatëve hitlerianë dhe tradhtarëve shqiptarë. Në qytetet, në vend që të shuhej, u ndez edhe më shumë lëvizja kryengritëse çlirimtare.

Përveç terrorit dhe grabitjeve, nazistët gjermanë dhe reaktionarët u munduan ta shtrëngonin popullin të lëshonte armët me anë të urisë. Ata bllokuan qytetet dhe fshatrat prodhuese të drithit që të mos shkonte asnjë kokërr misri dhe gruri në zonat malore, baza të partizanëve. Por edhe kjo orvatje dështoi.

Për të çoroditur popullin pushtuesit dhe veglat shpallën me bujë më se një herë se partizanët ishin shpartalluar dhe se Partia Komuniste qe asgjësuar. Por pikërisht në këtë kohë Ushtria Nacionalçlirimtare merrte në dorë iniciativën e vepri-meve dhe kalonte në kundërmësymje. Brenda shkurtit dhe marsit repartet dhe njësitë partizane në Shqipërinë e Jugut spas-truan gati gjithë krahinat e shkelura nga forcat gjermane e reaksionare gjatë operacionit. Marshimi heroik i një pjese të Brigadës I (shkurt-mars) thellë në prapavijat armike nëpër Çermenikë, Gollobordë, Mat, Shëngjergj, Pezë e Dumre e forcoi besimin e popullit në UNÇSH dhe ndihmoi në gjallërimin e Lëvizjes Nacionalçlirimtare në krahinat veriore të vendit.

Populli kryengritës dhe Ushtria e tij Nacionalçlirimtare ua shkatërruan pushtuesve e tradhtarëve planin e mësymjes së tyre të përgjithshme të dimrit 1943-1944. Në ndeshjet me armiqtë në fushën e luftës, nga të ftohtit, nga plagët e rënda dhe nga sëmundjet dhanë jetën lart nga 1000 partizanë, por radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare as u rralluan, as u dobësuan, përkundrazi u shtuan dhe u forcuan. Zbatimi i planit të Shtabit të Përgjithshëm për krijimin e brigadave të reja nuk u ndërpre. Gjatë dimrit u krijuan Brigadat IV, V, VI dhe VII. Në përleshjet me armiqtë, në vështirësitë dhe në vuajtjet, Ushtria Nacionalçlirimtare fitoi një kalitje të atillë morale që nuk e kishte njohur më parë. Komandantët, komisarët dhe luftëtarët e thjeshtë u pajisën me një përvojë të pasur ushtarake dhe politike. U përmirësua mjaft edhe gjendja e armatimit të reparteve e të njëjseve partizane me armë të reja gjermane të kapura në luftimet.

Pushtuesit e tradhtarët pësuan dëme në njerëz gati tri herë më shumë se partizanët. Por dëmet më të shumta të tyre ishin politike. Sidomos pjesa më e madhe e forcave reaksionare filloi të shikonte më qartë e më thellë kotësinë e luftës që bënte kundër Frontit Nacionalçlirimtar dhe e humbi besimin në fitoren e kësaj lufte.

Armiqtë nuk mundën të shkatërronin shumicën dërrmuese të këshillave nacionalçlirimtarë dhe as të bënin të ndërpri-



tej veprimtaria e tyre. Këshillat i dhanë një ndihmë të madhe Ushtrisë Nacionalçlirimtare, duke i siguruar asaj ushqime, veshmbathje, mjete transporti, sidomos duke e ushqyer atë me vullnetarë të rinj. Ato zhvilluan një veprimtari të gjallë për të mbajtur lart moralin dhe shpirtin luftarak të popullit, për të ndihmuar të dëmtuarit nga lufta dhe për të mos lënë të vdisnin urie masat fshatare.

Në mësymjen e përgjithshme armike të dimrit 1943-1944 Partia Komuniste, Ushtria Nacionalçlirimtare dhe mbarë populli shqiptar kaluan provën më të madhe dhe më të rëndë gjatë gjithë Luftës Nacionalçlirimtare.

Në këtë provë Ushtria Nacionalçlirimtare Shqiptare u tregua një ushtri e organizuar, e disiplinuar, me moral të lartë, besnike deri në fund ndaj atdheut dhe popullit. Ndonëse natë e ditë në luftë dhe në marshime, të veshur e të mbathur keq, të pangrënë, jashtë nëpër male të larta me dëborë, luftëtarët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare nuk u ankuan kurrë për vështirësitë dhe mungesat, nuk e humbën asnjëherë besimin në fitore dhe në drejtësinë e çështjes që ata mbronin. Partizanë të veçuar ose grupe partizanësh, të mbetur në rrethim nga të gjitha anët, pranonin njëqind herë më mirë të vdisnin nga të ftohtit dhe uria, ose të binin duke luftuar, se sa të dorëzoheshin tek armiqtë. S'kishte gjë më të shtrenjë për ta se sa të mbanin gjithmonë lart e të papërlyer emrin dhe nderin e luftëtarit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Komandantët dhe komisarët treguan mjeshtëri të lartë në përdorimin e taktikës partizane, zotësi, pjekuri politike në vlerësimin e situatave, në marrjen e vendimeve dhe iniciativë për veprime të pavarura.

Shtabi i Përgjithshëm me anë të anëtarëve të vet, që i kishte shpërndarë nëpër zonat e ndryshme të vendit, ndiqte zbatimin e urdhrave dhe të udhëzimeve që kishte dhënë më parë, bënte vlerësimin e situatave nga ana ushtarake e politike dhe jepte udhëzime të reja të nevojshme. Me gjithë shpërqendrimin e madh të forcave asnjëherë nuk u ndërpre kontrolli, ndihma dhe udhëheqja e tij në ushtri. Rreziku më i madh në këtë kohë ishte të binte fryma luftarake sulmuese e reparteve dhe njërive dhe të krijoheshin ndjenja për një pushim, për një çlodhje pas operacionit. Shtabi i Përgjithshëm e mënjanoi një rrezik të tillë, duke kërkuar nga Ushtria Nacionalçlirimtare të hidhej pa prituri në kundërmësymje. Sulmi,

mësonte Shtabi, mban lart moralin e ushtrisë, ekonomizon kohën dhe energjitë, demoralizon armikun, zhvleftëson shumë numerike dhe epërsinë teknike të tij. Sulmi është e vetmja mënyrë lufte që i përshtatet ushtrisë revolucionare. Shpirti sulmues i luftëtarëve zhvillohet me luftë të vazhdueshme kundër pushtuesit dhe reaksionit, duke e kërkuar luftën dhe jo duke pritur që të të gjejë ajo.

Në periudhën e rëndë të dimrit 1943-1944 u provua shka-lla e lartë e ndërgjegjes dhe e gatishmërisë së popullit shqiptar për të përballuar theroritë e shumta që kërkonte lufta çlirimtare, bashkimi i tij i çeliktë rreth Partisë në Frontin Nacionalçlirimtar. Ishte ndihma dhe mbështetja e masave popullore ajo që e shpëtoi Ushtrinë Nacionalçlirimtare nga asgjësimi, ajo që i jepte zemër, që ia shumëfishonte forcat dhe e bënte të dilte ngadhënjimtare në luftën e pabarabartë. Fshatarët nuk ua mbyllën kurrë derën partizanëve të lodhur në luftime, ndanë me ta copën e fundit të bukës që kishin ruajtur për fëmijët e tyre. Nëpër qytete të rinjtë, gratë dhe pionierët, pa përfillur rreziqet, shpërndanin materiale propagandistike të Partisë, merrnin pjesë në mbajtjen e lidhjeve midis organeve të Partisë dhe Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Një numër të rinjsh, grash dhe pionierësh dhanë jetën, shumë u burgosën dhe u internuan, por terrori armik nuk e përkuli vullnetin e tyre.

Tradhtarët dhe nazistët gjermanë bënë përpjekje sidomos për të shkëputur rininë nga Partia Komuniste dhe për ta detyruar atë të dorëzonte armët. Ja si u përgjigjej rinia thirrjes dhe kanosjeve të armiqve: «Për Rininë Antifashiste Shqiptare ka vetëm një rrugë, vetëm një vendim: luftë deri në fitore... Rinia Antifashiste nuk ligshtohet para litarit, nuk tronditet para plumbit, nuk e humbet kurajën përpara sulmeve të armikut dhe të tradhtarëve. Ajo ka bindjen në fitoren e kauzës së saj e të popullit. Ajo ka vendosur të fitojë me çdo kusht. Dhe do të fitojë»<sup>1</sup>.

---

1 «Përgjigje». Trakt i BRASH-it, 17 janar 1944. AQP.

## **Provë e madhe e drejtësisë së vijës politike të PKSH**

Frymëzuese e organizuese e qëndresës dhe e luftës heroike të UNÇSH, të mbarë po-

pullit shqiptar në periudhën më të vështirë, në dimrin 1943-1944, ishte Partia Komuniste.

Në këtë periudhë u vërtetua edhe më qartë sa të shëndosha dhe të pathyeshme ishin lidhjet e Partisë me masat, sa e drejtë ishte vija politike e saj. Në asnjë çast luftëtarët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe masat popullore nuk e humbën besimin te Partia. Me emrin e Partisë Komuniste në gojë vdisnin në fushat e betejës, në litar dhe në tortura, bijtë dhe bijat e popullit shqiptar. Për ta ruajtur Partinë nga goditjet e armiqve, mijëra njerëz të thjeshtë të popullit pranonin çdo therori.

Në dimrin 1943-1944 lidhjet e Partisë me masat u forcuan edhe më shumë. Populli shqiptar e pa edhe më mirë, e kuptoi edhe më thellë se Partia Komuniste ishte e vetmja forcë udhëheqëse, e zonja për të siguruar zhdukjen e zgjedhës së huaj, për të fituar lirinë e pavarësinë kombëtare, për të mbrojtur interesat e popullit shqiptar.

Në çastet më të vështira dhe më të rrezikshme luftëtarët e UNÇSH dhe masat e popullit kudo, në fshat e në qytet, në zonat e lira dhe të pushtuara, e ndienin nga afër dorën e Partisë, e shikonin që Partia nuk i kishte braktisur, ushqeheshin çdo ditë me mësimet dhe fjalën e saj shpëtimtare.

Edhe në kohën e luftimeve më të ashpra, edhe gjatë marshimeve të rënda, komisarët e seksionet politike, organizatat e partisë zhvillonin një punë politike të gjithanshme e të gjallë dhe kështu e mbanin kurdoherë lart moralin dhe shpirtin luftarak të partizanëve, nuk linin të dobësohej bindja në fitoren. Mbledhjet e organizatave të partisë bëheshin në çdo rrethanë, sado kritike që të ishte ajo. Në to merreshin vendime kolegjiale për të siguruar suksesin e veprimeve luftarake, rolin pararojë të komunistëve si në luftë ashtu dhe në përballimin e vuajtjeve e të mungesave. Në periudhën e dimrit 1943-1944 numri i anëtarëve të partisë në ushtri u rrit me komunistë të sprovuar në përleshjet me armiqtë, në situatat e ndërlikuara.

Në qytetet dhe krahinat e pushtuara, ndonëse kishte mbetur një numër i kufizuar komunistësh, puna e Partisë nuk u dobësua. Komitetet qarkore të partisë riorganizuan punën e

celulave dhe të aktiveve të Rinisë Komuniste në përshtatje me gjendjen e terrorit dhe të ndjekjeve të egra nga ana e armiqve. Organizatat e partisë në qytetet e pushtuara nuk e ndërprejnë asnjëherë botimin dhe shpërndarjen e buletineve, komunikatave, trakteve dhe thirrjeve drejtuar popullit. Armiqtë i tërbonte fakti që nuk ishin të zotë të zbulonin teknikën, ku shtypeshin këto materiale, të shkatërronin organizatat e partisë, këshillat nacionalçlirimtarë, organizatat antifashiste të rinisë e të gruas, njësitet guerile. Aksionet e guximshme që kryenin njësitet guerile, sipas planit të komiteteve qarkore, nuk e linin për asnjë çast të qetë armikun dhe nuk lejonin të binte poshtë morali i popullsisë së qyteteve. Komitetet qarkore të partisë tregonin kujdes të madh e të vazhdueshëm për veprimtarinë e çdo komunisti, i mbanin anëtarët e partisë gjithnjë në dijeni të ngjarjeve, nuk lejonin asnjëherë që ata të binin në mosveprim, u jepnin udhëzime dhe u ngarkonin detyra konkrete. Komunistët tregonin shumë kujdes sidomos ndaj njerëzve që lëkundeshin, u jepnin zemër atyre dhe nuk i linin të binin viktimë e presionit të armikut. Ata mbanin lidhje me të burgosurit politikë dhe me partizanët e shkëputur, të sëmurë e të plagosur që kishin hyrë në qytet. Në burgjet dhe në kampet e përqendrimit vepronin celulatat e partisë. Komitetet qarkore organizonin mbledhjen e ndihmave materiale, të veshmbathjes dhe barnave për Ushtrinë Nacionalçlirimtare, grumbullonin njoftime mbi gjendjen dhe planet e armiqve dhe ua dërgonin shtabeve partizane.

Gjatë dimrit 1943-1944 u provua më së miri vetëmohimi dhe besnikëria e komunistëve shqiptarë ndaj Partisë, popullit dhe komunizmit. Shumë anëtarë partie, nëntë anëtarë të komiteteve qarkore, një komisar brigade dhe kandidati i Komitetit Qendror, Vasil Shanto, dhanë jetën si heronj të vërtetë në përleshjet me hitlerianët dhe reaksionarët. Shembulli dhe heroizmi i komunistëve i frymëzonte masat popullore në qëndresën dhe luftën kundër pushtuesit e tradhtarëve.

Rëndësi shumë të madhe në ato çaste të vështira e situata të ndërlikuara pati udhëheqja e pandërprerë e Komitetit Qendror të Partisë, e vetë shokut Enver Hoxha. Ata mbanin lidhje të përhershme me komitetet qarkore e me organet politike të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Gjithashtu Sekretari i Përgjithshëm nuk i shkëputi asnjëherë lidhjet me anëtarët e Komitetit Qendror, të shpërndarë në të gjitha anët e vendit

për të udhëhequr nga afër luftën. Këto lidhje siguroheshin duke kapërcyer një mijë pengesa dhe rreziqe dhe nuk u ndërprejnë as në çastin kur udhëheqësit kryesorë të Partisë ndodheshin të bllokuar në malet e Çermenikës e të Shëngjergjit. Udhëheqja e Komitetit Qendror studionte me vëmendjen më të madhe raportet dhe njoftimet, nxirrte konkluzione dhe bënte përgjithësime mbi gjendjen në tërësi dhe mbi gjendjen e veprimtarinë e Partisë në çdo terren e në çdo repart ushtarak. Mbi këtë bazë hartonte dhe dërgonte udhëzimet e nevojshme, kritikonte gabimet e të metat dhe i mësonte shokët si të vepronin për zgjidhjen e problemeve të koklavitura. Sekretari i Përgjithshëm vinte në dijeni për problemet e rëndësishme të gjithë anëtarët e Komitetit Qendror, u kërkonte atyre të jepnin mendime dhe të bënin propozime për këto probleme.

Atje ku ka popull duhet të jemi dhe ne sado i madh që të jetë reaksioni, udhëzonte Komiteti Qendror. Ky ishte parimi themelor që i udhëhiqte organizatat e partisë në veprimtarinë praktike, për të mos lënë që të binte poshtë morali i masave në çastet e rënda që kalonte vendi, për të asgjësuar presionin e armiqve mbi popullsinë. Udhëheqja e Partisë kritikoi në këtë kohë Komitetin Qarkor të Vlorës, sepse pati humbur për një çast lidhjet me qytetin.

Kujdes të veçantë tregonte Komiteti Qendror për rininë, që të mos epej dhe të mos tërhiqej nga lufta, meqenëse vëmendjen kryesore edhe armiqtë e kishin drejtuar te rinia. Nën kujdesin e drejtpërdrejtë të udhëheqjes së Partisë dështuan të gjitha orvatjet e pushtuesve e të tradhtarëve për ta detyruar rininë të largohej nga Ushtria Nacionalçlirimtare. U demaskua zhurma shurdhuese që ngritën nazistët e reaksionarët në lidhje me disa deklarata antikomuniste, të përgatitura prej tyre dhe të nënshkruara nga të rinj të veçuar që u lëkundën në çastet e vështira. Nuk patën asnjë sukses përpjekjet e armiqve për ta tërhequr rininë me anë të klubeve e të rretheve sportive e kulturore. U dërrmua që në embrion orvatja për të krijuar të ashtuquajturën organizatë të «rinisë indipendente».

Shoku Enver Hoxha, porsa mori vesh se në Komitetin Qarkor të Tiranës ishte shprehur një mendim për të lejuar disa të rinj të deklararin «se nuk merren me politikë», si shkas për të shpëtuar nga burgosja dhe internimi, e kritikoi rëndë këtë pikëpamje dhe tërhoqi vërejtjen për të mos rënë

në asnjë rast në kurthin e armiqve. Udhëheqja e Komitetit Qendror e hodhi poshtë gjithashtu një propozim për të formuar një «parti republikane demokratike» me elementë të Frontit Nacionalçlirimtar, me qëllim gjoja që të tërhiqeshin në Front njerëz të Ballit Kombëtar që ishin kundër krerëve të tyre. Formimi i një partie të tillë u quajt një gjë krejt artificiale dhe e dëmshme për luftën çlirimtare.

Një vëmendje të madhe tregonte Komiteti Qendror që drejtuesit e Partisë në ato rrethana kaq të rënda të mos binin në pesimizëm dhe të mos humbisnin besimin në forcat e veta, në forcat e gjithë Partisë e të popullit. Duke kritikuar disa shfaqje pesimizmi që u vunë re aty këtu gjatë dimrit 1943-1944, shoku Enver Hoxha udhëzonte: «Me të vërtetë situata është e vështirë, shumë e vështirë..., por bash në këto situata të vështira të përpiqemi të mos humbasim nordin...» (pikësytimin, drejtimin — **Red.**)<sup>1</sup>

Duke prekur çështjen e humbjeve të pësuar nga disa reparte partizane, ai e quante një gabim të madh rënien në dëshpërim për shkak të këtyre humbjeve. Nuk ka luftë pa humbje dhe pa dëme, tregonte ai. Kryesorja është të mos e humbasësh toruan, të mos humbasësh besimin në forcat e veta e të popullit, të dish të grumbullosh forcat, të manovrosh me mjeshtëri, të vësh në vend humbjet, të jesh i përgatitur për rrethanat më të këqija që mund të krijohen dhe të jesh i zoti ta kthesh gjendjen në dobinë tënde. S'ka gjë më të rrezikshme se humbja e toruas dhe mosveprimi në situatat kritike.

Mbi të gjitha Komiteti Qendror kishte kujdes të ruhej Partia, të mbaheshin të pastra dhe të forta radhët e saj. Ai i porosiste kuadrot drejtues të punonin jo vetëm me trimëri, por edhe me mend, të mos futeshin qorrazi nëpër rreziqe kur s'ishte nevoja. Në radhë të parë ata lypsej të shquheshin si udhëheqës politikë të matur e të urtë, të dinin të organizonin punën në përshtatje me rrethanat, të tregoheshin vigjilentë ndaj taktikës e mjeteve që përdorte armiku për të shfarosur kuadrot drejtues dhe për të shkatërruar organizatat e partisë. Komiteti Qendror kërkonte vazhdimisht të ruhej Partia nga provokatorët që mund të fuste me qëllim armiku në ra-

---

<sup>1</sup> Enver Hoxha. Letër drejtuar shokut Nako Spiru, mars 1944. Vepra, vëll. 2, f. 115-116.

dhët e saj, të qëndrohej syhapur ndaj atyre që kishin pasë shfaqur më parë frymë të theksuar grupazhi, sepse kjo frymë kishte rrezik të ringjallej në ato situata të vështira. Vigjilenca e Partisë dhe kalitja politike e komunistëve bëri të mënjanoheshin rreziqe të këtij lloji.

Edhe në ato rrethana të rënda të dimrit 1943-1944 Komiteti Qendror gjeti kohën dhe mundësinë për të organizuar një kurs teorik, në Panarit të qarkut të Korçës, me kuadro kryesorë të partisë në Ushtrinë Nacionalçlirimtare dhe kuadro të partisë në terren.

Si pasojë e një kujdesi dhe veprimtarie të gjallë të Komitetit Qendror dhe të gjithë organeve drejtuese të partisë në terren dhe në ushtri, asnjëherë më parë puna e Partisë nuk kishte qenë aq frytdhënëse, asnjëherë Partia nuk ishte treguar kaq monolite dhe kaq e pjekur sa në këtë periudhë. Përballë forcës dhe autoritetit të Partisë Komuniste dështuan të gjitha orvatjet e armiqve për ta shkatërruar ose për ta dobësuar atë. Vajtën kot përpjekjet e Gestapos hitleriane dhe të Ballit Kombëtar për të krijuar një «parti komuniste të vërtetë» dhe një «parti socialdemokrate» që do të zëvendësonin Partinë Komuniste të Shqipërisë.

Luftimet e ashpra dhe vuajtjet e rënda në dimrin 1943-1944 e forcuan kalitjen revolucionare të Partisë Komuniste, të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, të këshillave nacionalçlirimtarë dhe të mbarë popullit shqiptar, i përgatitën për betejat vendimtare në luftën kundër pushtuesve nazistë e tradhtarëve.

## 8. THEMELIMI I SHTETIT TË RI TË DEMOKRACISË POPULLORE

Pas dështimit të mësymjes së përgjithshme armike të dimrit, në pranverë të vitit 1944 Lufta Nacionalçlirimtare në Shqipëri mori një vrull të ri. Që në mars iniciativa e veprimeve luftarake kishte kaluar në duart e reparteve e të njësi-ve partizane. Në bazë të urdhrit të Shtabit të Përgjithshëm të 5 prillit UNÇSH nga mbrojtja u hodh në kundërmësymje strategjike. Trupat naziste të pushtimit dhe forcat reaksionare u shtrënguan përsëri të mbylleshin në qytetet nëpër kazerma dhe qendra të fortifikuara gjatë rrugëve kryesore e gjatë bregde-

tit, nën kanosjen e përhershme të goditjeve të luftëtarëve të UNÇSH.

Rritja e vullshme e Luftës Nacionalçlirimtare e thelloi pa masë krizën në radhët e armiqve në Shqipëri. Në gjirin e organizatave dhe të forcave të armatosura reaksionare filloi shthurja.

UNÇSH deri në maj 1944 qe rritur në 35 mijë luftëtarë. Ajo ishte plotësisht në gjendje të fillonte mësymjen e përgjithshme për çlirimin e qyteteve dhe të mbarë vendit.

Kjo perspektivë bëhej edhe më e qartë si rrjedhim i fitoreve të shkëlqyera të Ushtrisë së Kuqe mbi ushtrinë gjermane. Që nga janari 1944 trupat sovjetike kishin filluar një mësymje vigane në Frontin e Lindjes. Duke përparuar pa u ndalur drejt perëndimit, në prill ato hynë në Rumani. Trupat gjermane në Ballkan u vunë kështu përpara rrezikut të rrethimit.

### **Për shkatërrimin e manovrave të reja të armiqve**

Në këtë gjendje krize dhe alarmi armiqtë zhvilluan përpjekje për të gjetur

me çdo mënyrë një rrugëdalje dhe për të ndryshuar gjendjen në dobi të tyre. Shpresa të mëdha kishin vënë ata në ndërmarrjen e një mësymjeje të re të përgjithshme kundër Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Hitlerianët kishin llogaritur që këtë mësymje ta fillonin në prill. Por nuk mundën, sepse UNÇSH ua prishi llogaritë me kundërmësymjen e saj dhe sepse dështoi orvatja për rekrutim mercenarësh për shkak të qëndresës së popullit kundër këtij plani.

Në të njëjtën kohë tradhtarët shqiptarë u përpoqën të luanin karta të reja. Ata u munduan të krijonin një koalicion të reaksionit greko-shqiptar, me perspektivë që ky të kthehej në një aleancë ushtarake greko-turko-shqiptare. Përpjekjet e tradhtarëve dështuan që në embrion përballë forcës së luftës revolucionare të popullit shqiptar.

Të njëjtin fat pësoi dhe orvatja e reaksionarëve për të mashtruar popullin me anë të shpalljes me bujë të disa masave me karakter ekonomik, si «reforma agrare» dhe krijimi i një «shoqërie për zhvillimin ekonomik të vendit». Këto masa, premtinin tradhtarët, do të zhduknin prapambetjen ekonomike që ishte, sipas tyre, shkak i krizës së rëndë në Shqipëri! Por këto premtime të bukura nuk mund të gënjenin



popullin shqiptar. Ai tashmë ishte i bindur se vetëm me çlirimin e atdheut dhe me asgjësimin e tradhtarëve do të mund të plotësonte ëndrrat dhe dëshirat e tij.

Kolaboracionistëve shqiptarë, në ato çaste të krizës së thellë që po kalonin, u erdhi në ndihmë reaksioni imperialist anglo-amerikan. Komanda e trupave aleate të Mesdheut e shtoi ndihmën me armë dhe me mjete të tjera për forcat reaksionare të Legalitetit, të Ballit Kombëtar dhe të bajraktarëve tradhtarë. Misioni ushtarak anglez u mundua të bindte Shtabin e Përgjithshëm të UNÇSH të mos ndërmerre ndonjë lëvizje forcash drejt Shqipërisë së Veriut, sepse ajo ishte zonë veprimi e Legalitetit! Në Londër qeveria britanike i shtoi përpjekjet për krijimin e një qeverie shqiptare reaksionare në mërgim.

Çastet që kalonte vendi në pranverën e vitit 1944 Partia Komuniste i vlerësoi si vendimtare për fatin e revolucionit popullor në Shqipëri. Në këto çaste dilte e nevojshme të asgjësohej çdo përpjekje e armiqve për të ndryshuar gjendjen në dobi të tyre, të digjeshin të gjitha kartat e reaksionit të brendshëm e të jashtëm, të merreshin masa të atilla ushtarake e politike që të siguronin çlirimin e plotë të vendit dhe triumfin e revolucionit popullor. Në kushtet konkrete Komiteti Qendror përcaktoi si hallkë kryesore forcimin dhe ligjësimin e pushtetit të këshillave nacionalçlirimtarë, si i vetmi pushtet i ligjshëm i popullit shqiptar, krijimin e shtetit të ri shqiptar me qeverinë e vet demokratike dhe me ushtrinë e vet të rregullt.

### **Kongresi i Përmetit. Krijimi i shtetit të demokracisë popullore**

Për këtë qëllim u vendos thirrja e Kongresit I Antifashist Nacionalçlirimtar, i cili do të merrte në shqyrtim

zgjidhjen e problemeve politiko-ushtarake që lypte gjendja e krijuar. Propozimi i Komitetit Qendror të PKSH për thirrjen e Kongresit u diskutua dhe u pranua në mbledhjen e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar në prill 1944.

Në të njëjtën kohë Shtabi i Përgjithshëm, sipas direktivave të Komitetit Qendror, filloi hartimin e planit për shndërrimin e gjithë Ushtrisë Nacionalçlirimtare në ushtri të rregullt dhe të planit operativo-strategjik për çlirimin e mbarë tokës shqiptare nga nazistët gjermanë e tradhtarët.

Këto probleme të mëdha politike dhe ushtarake u morën në shqyrtim në mbledhjen e Plenumit të Komitetit Qendror të PKSH që u mbajt më 15 maj 1944 në Helmës të Skraparit. Plenumi miratoi vendimin e udhëheqjes së Komitetit Qendror dhe të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm për thirrjen e Kongresit I Antifashist. U gjetën plotësisht me vend masat për krijimin e qeverisë demokratike të përkohshme dhe për shndërrimin e gjithë Ushtrisë Nacionalçlirimtare në ushtri të rregullt. Komiteti Qendror vlerësoi drejt rrezikun që i vinte Luftës Nacionalçlirimtare, pavarësisë kombëtare dhe revolucionit popullor nga veprimtaria armiqësore e qeverive britanike e amerikane dhe ritheksoi vendosmërinë për të mos i lejuar cilitdo goftë nga aleatët të përzihej në punët e brendshme politike dhe ushtarake të popullit shqiptar.

Për t'i dalë gjendjes përpara, duke pasur parasysh shfaqje pikëpamjesh jo të drejta që ishin dukur aty-këtu ose mund të dukeshin në të ardhmen në Parti, në ushtri ose në Front, Plenumi tërhoqi vëmendjen në dy çështje të rëndësishme rreth vijës së Partisë. Ai paralajmëroi të mos bëhej asnjë ndryshim në parullat e Partisë, të ruhej deri në fund karakteri nacionalçlirimtar i luftës. U vu detyrë të popullarizohej edhe më shumë Partia Komuniste si udhëheqëse, por gjithnjë brenda vijës së Luftës Nacionalçlirimtare. Komiteti Qendror e argumentoi këtë me faktin se etapa antifashiste, antiimperialiste, demokratike e revolucionit nuk kishte mbaruar dhe nuk mund të mbaronte pa çlirimin e plotë të Shqipërisë dhe vendosjen e përforcimin e pushtetit demokratik popullor. Nga ana tjetër, ai udhëzoi të luftohej çdo mendim se me mbarimin e Luftës Nacionalçlirimtare çdo gjë merrte fund dhe se luftëtarët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, me largimin e gjermanëve, do të lëshonin armët dhe do të ktheheshin nëpër shtëpi. Plenumi kërkonte të bëhej e qartë mirë se populli shqiptar do t'i mbante armët në dorë edhe pas çlirimit të vendit për të siguruar liritë e plota, për të zhdukur çdo armik, për të mbrojtur fitoret e arritura dhe për t'i zhvilluar ato më tej. Ai porositi Partinë të studionte me kujdes rrethanat e reja që do të krijoheshin, të parashikonte me kohë qëndrimet dhe masat e nevojshme.

Plenumi dënoi njëzëri kapitullimin e Ymer Dishnicës në Mukje dhe kompromisin e Gjin Markut me gjermanët në Berat. Për këto faje të rënda i përjashtoi që të dy nga Komiteti Qendror i Partisë.

Masat popullore e pritën me entuziazëm vendimin për mbajtjen e Kongresit. Në mitingje e mbledhje të gjera populli shprehte besnikërinë dhe dashurinë ndaj Partisë Komuniste, falënderonte Partinë për udhëheqjen e drejtë dhe luftën heroike në mbrojtjen e interesave të atdheut, tregonte gatishmërinë për të luftuar deri në fund kundër pushtuesve e tradhtarëve, mbështeste vendimin për thirrjen e Kongresit dhe për krijimin e qeverisë demokratike të përkohshme.

Për shkak të rrethanave të luftës zgjedhjet e delegatëve të Kongresit u bënë me votim të hapët. Megjithatë, ato ishin të parat zgjedhje demokratike në Shqipëri. Në to morën pjesë edhe gratë, të cilat gëzonin për herë të parë në historinë e vendit të drejtën e votës në zgjedhjet për pushtetin politik. Për herë të parë përfaqësuesit e popullit nuk u zgjodhën në bazë të shkallës fisnore e të pasurisë, por në bazë të meritave në luftën kundër armiqve të atdheut e të popullit. Delegatët e Kongresit përfaqësonin masat popullore kryengritëse.

Zgjedhjet për Kongresin treguan pjekurinë politike dhe ndërgjegjen e lartë të masave popullore. Ato ishin një provë tjetër e madhe e lidhjeve të shëndosha të Partisë Komuniste me popullin.

Hitlerianët dhe reaksionarët vunë të gjitha forcat për të zbuluar vendin e mbledhjes në mënyrë që të drejtonin kundër Kongresit një sulm të armatosur. Por qëllimit nuk ia arritën dot. Imperialistët anglo-amerikanë bënë presion të madh dhe nuk lanë mjet pa përdorur që të sabotonin mbajtjen e tij. Qeveria britanike e quajti «të paligjshme» mbajtjen e Kongresit Antifashist dhe i dha urdhër kryetarit të misionit ushtarak anglez në Shqipëri të mos e pranonte ftesën që Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar i kishte bërë për të marrë pjesë me cilësinë e përfaqësuesit aleat. Etli, zëvendëskryeministër dhe më vonë kryeministër i Britanisë së Madhe, duke folur në Dhomën e Komuneve një ditë para se të mbahej Kongresi, luftën burrërore të popullit shqiptar nën udhëheqjen e Partisë Komuniste ua veshi më tepër Legalitetit e Ballit Kombëtar, armiqve të kësaj lufte.

Partia Komuniste, që ndiqte me vëmendje dhe me sy hapur shtjellimin e gjendjes, bëri që t'u shkonin kot të gjitha përpjekjet armiqve, kurse Kongresi zhvilloi punimet e veta me sukses të plotë sipas planit të caktuar.

Kongresi I Antifashist Nacionalçlirimtar i Shqipërisë u mbajt prej 24 deri më 28 maj 1944 në qytetin e lirë të Përmetit Punimet e Kongresit u përshkuan nga një frymë thellësisht revolucionare dhe uniteti të plotë. Delegatët diskutuan gjallërisht rreth raportit «Mbi zhvillimin e Luftës Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar në lidhje me ngjarjet ndërkom-bëtare» që mbajti shoku Enver Hoxha në emër të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar. Ata dhanë njëzëri pëlqimin për të gjitha propozimet e paraqitura.

Kongresi zgjodhi Këshillin Antifashist Nacionalçlirimtar (KANÇ) si trupin më të lartë legjislativ dhe ekzekutiv në Shqipëri, si përfaqësuesin e sovranitetit të popullit dhe të shtetit shqiptar. Këshilli Antifashist i zgjedhur në Përmet ishte ku-vendi i parë popullor i Shqipërisë. Kongresi ngarkoi Këshil-lin Antifashist të formonte Komitetin Antifashist Nacionalçlirimtar me atributet e qeverisë së përkohshme demokratike popullore. Komiteti Antifashist, i cili u pranua në Kongres, ishte qeveria e parë demokratike popullore e Shqipërisë. Pre-sident i Komitetit u emërua Sekretari i Përgjithshëm i PKSH, Enver Hoxha.

Duke krijuar organet e larta të pushtetit popullor, Kon-gresi i Përmetit vendosi: «Të ndërtohet Shqipëria e re demo-kratike popullore sipas vullnetit të popullit që sot e shpreh solemnisht në Këshillin Antifashist Nacionalçlirimtar»; t'i nda-lohet ish-mbretit Zog kthimi në Shqipëri; të mos njihet asnjë qeveri tjetër që mund të krijohet brenda ose jashtë vendit kundër vullnetit të popullit shqiptar; të vazhdohet më me ash-përsi lufta kundër pushtuesve gjermanë dhe tradhtarëve shqip-tarë deri në shkatërrimin e tyre të plotë dhe vendosjen e pushtetit të demokracisë popullore në gjithë vendin.

Këshilli Antifashist në mbledhjen e parë mori një varg vendimesh shumë të rëndësishme, të cilat u miratuan nga Kongresi dhe që përbëjnë ligjet e para të shtetit shqiptar të demokracisë popullore. Rëndësi të posaçme pati vendimi me përmbajtje revolucionare për të prishur të gjitha marrëveshjet politike dhe ekonomike që kishte lidhur qeveria e Zogut me shtetet e huaja dhe që vinin në kundërshtim me interesat e popullit shqiptar. Këshilli krijoi një komision shtetëror të po-saçëm për zbulimin dhe vërtetimin e kriminelëve të luftës dhe të të gjitha krimeve të kryera nga pushtuesit e tradhtarët.

Lidhur ngushtë me çështjet e organizimit të pushtetit popullor në një shkallë më të lartë, Kongresi analizoi e zgjidhi edhe çështjet e forcimit të mëtejshëm e të përsosjes së Ushtrisë Nacionalçlirimtare, si arma kryesore për çlirimin e plotë të vendit e për mbrojtjen e pushtetit të ri. Në Kongres u vendos njësimi i komandës së lartë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe dhënia e gradave ushtarake. Shoku Enver Hoxha u emërua Komandant i Përgjithshëm. Kongresi dha orientimin për krijimin e divizioneve e të korparmatave. Komanda e Përgjithshme shpalli formimin e Divizionit I Sulmues.

Kongresi i Përmetit shprehu mirënjohjen ndaj Bashkimit Sovjetik dhe Ushtrisë së Kuqe të udhëhequra nga J. Stalini që me luftën e tyre heroike shpejtonin çlirimin e Shqipërisë dhe të vendeve të tjera të robëruara nga fashistët. Ai ritheksoi besnikërinë ndaj aleancës së madhe antifashiste dhe miqësinë e popullit shqiptar me të gjithë popujt pjesëtarë të kësaj aleance. Por ndryshe nga kongreset dhe kuvendet e shqiptarëve në të kaluarën, Kongresi i Përmetit nuk i bëri askujt lutje për ndihmë në zgjidhjen e problemeve dhe vendosjen e fateve të Shqipërisë. Përkundrazi, ai i paralajmëroi fuqitë imperialiste se kishte kaluar përgjithmonë ajo kohë kur Shqipëria përdorej si monedhë tregu e se populli shqiptar nuk lejonte më të bëheshin pazarllëqe në kurriz të tij. Ai do t'i vendoste dhe do t'i zgjidhte vetë fatet e tij. Kongresi i dënoi botërisht orvatjet e aleatëve anglo-amerikanë për t'u përzier në punët e brendshme politike dhe ushtarake të Shqipërisë.

Vendimet historike të Kongresit të Përmetit u pritën me gëzim të madh dhe u përqaftuan menjëherë nga masat e gjera popullore.

Përpjekjet e Partisë Komuniste për shkatërrimin e pushtetit të vjetër antipopullor dhe për ngritjen e pushtetit demokratik popullor në zjarrin e Luftës Nacionalçlirimtare qenë kurorëzuar me një fitore të madhe. Konferenca e Pezës vuri themet e këtij pushteti. Konferenca e Labinotit e centralizoi atë dhe e shpalli të vetmin pushtet politik në Shqipëri. Kongresi i Përmetit e zgjidhi problemin e pushtetit politik në dobi të popullit kryengritës. Ai themeloi shtetin shqiptar të demokracisë popullore. Vendimet e Kongresit përbëjnë bazën e kushtetutës së këtij shteti.

Paskëtaj reaksioni i brendshëm vetëm me forcat e tij, as edhe me përkrahjen e pushtuesve hitlerianë, nuk ishte i aftë të rivendoste pushtetin çifligaro-borgjez.

Në kohën e Kongresit të Përmetit gjysma e Shqipërisë ndodhej ende nën kontrollin e pushtuesve nazistë gjermanë dhe të tradhtarëve. Në krahinat dhe qytetet e pushtuara këshillat nacionalçlirimtarë vepronin në ilegalitet. Në mjaft krahina nuk kishte fare këshilla. Por kjo nuk ishte kryesorja. Kryesoren e përbënte fakti që pas Kongresit të Përmetit populli shqiptar, si në zonat e çliruara ashtu edhe në të paçliruara, njihte në të vërtetë për qeveri të vet vetëm Komitetin Antifashist dhe u bindej urdhrave të tij e vendimeve të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar. UNÇSH e ruante pushtetin demokratik popullor nga goditjet e armiqve dhe ishte në gjendje të siguronte me forcat e veta, me mbështetjen e fuqishme të popullit kryengritës, brenda një të ardhme fare të afërt, çlirimin e plotë të Shqipërisë dhe vendosjen e këtij pushteti në mbarë vendin.

Vendimet e Kongresit I Antifashist për krijimin e shtetit të demokracisë popullore, për formimin e Këshillit Antifashist dhe të qeverisë demokratike të përkohshme nuk ishin dekrete të thjeshta. Shteti i ri shqiptar dhe organet e larta të tij ishin pjella të luftës çlirimtare revolucionare të popullit shqiptar nën udhëheqjen e Partisë Komuniste.

Pushteti i këshillave nacionalçlirimtarë në Shqipëri ishte krejt i ndryshëm nga pushteti i vjetër si nga forma ashtu edhe nga përmbajtja. Ai s'kishte asgjë të përbashkët as me ndonjë lloj pushteti në republikat parlamentare borgjeze. Si tip pushteti politik u shëmbëllente Komunës së Parisit dhe sovjetëve. Megjithatë, ai ruante origjinalitet të plotë në përshtatje me kushtet objektive të Shqipërisë dhe me rrethanat e Luftës Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar.

Sipas vendimeve të Kongresit të Përmetit, këshillat dhe Komiteti Antifashist ngarkoheshin t'i jepnin ndihmë të gjithanshme Ushtrisë Nacionalçlirimtare për çlirimin e plotë të vendit; të siguronin në mbarë Shqipërinë triumfin e demokracisë popullore, ku të mos kishte mundësi rivendosja e regjimit të Zogut ose e ndonjë regjimi tjetër reaksionar; të zhduknin mbeburinat e fashizmit dhe metodat e vjetra të qeverisjes, të organizonin jetën shoqërore dhe shndërrimin e gjithanshëm të atdheut, zhvillimin e ekonomisë kombëtare dhe të kulturës.

Nga përmbajtja klasore dhe nga detyrat që kryente, push-teti i këshillave nacionalçlirimtarë përfaqësonte një diktaturë demokratike të forcave revolucionare nën udhëheqjen e drejt-përdrejtë e të vetme të Partisë Komuniste.

Zgjidhja e problemit të pushtetit popullor tregonte se ishte kryer njëra nga detyrat strategjike të Partisë. Megjithatë, ky problem, nuk mund të quhej i zgjidhur përfundimisht sa kohë që ende nuk ishte zgjidhur detyra tjetër strategjike — çlirimi i plotë i Shqipërisë nga pushtuesit gjermanë.

Vendimet e Kongresit të Përmetit ishin një grusht i rëndë për pushtuesit, për reaksionin e brendshëm dhe për reaksionin imperialist anglo-amerikan. Ato kishin rëndësi shumë të madhe për të hedhur poshtë zgjedhën imperialiste dhe për çlirimin shoqëror të popullit shqiptar.

## 9. ÇLIRIMI I PLOTË I SHQIPËRISË. FITORJA E REVOLUCIONIT POPULLOR

Më 28 maj 1944 Komandanti i Përgjithshëm, Enver Hoxha, i dha urdhër Ushtrisë Nacionalçlirimtare të hidhej në mësymje të përgjithshme për çlirimin e plotë të Shqipërisë nga pushtuesit gjermanë dhe për shkatërrimin rrënjësor të Ballit Kombëtar, të Legalitetit dhe të gjithë forcave reaksionare. Në bazë të planit operativo-strategjik, të hartuar me hollësi nga Shtabi i Përgjithshëm, Divizioni I Sulmues u ngarkua të kalonte në mësymje kundër armiqve në veri të Shkumbinit.

Plani i Komandës së Përgjithshme për çlirimin e plotë të vendit kishte qëllim njëkohësisht të siguronte dështimin e orvatjeve që bënte komanda anglo-amerikane e Mesdheut për të ndaluar kalimin në mësymje të përgjithshme të UNÇSH dhe për të mënjanuar shkatërrimin e forcave reaksionare. Në plan parashikohej edhe ndjekja e trupave hitleriane përtej kufijve shtetërorë.

### **Dështimi i mësymjes armike të qershorit 1944**

e UNÇSH në mësymje të përgjithshme, filloi një mësymje tjetër e madhe armike. Pushtuesit hodhën drejtpërdrejt në mësymje katër divizione e gjysmë gjermane dhe disa mijëra

Më 28 maj 1944, ditën që shoku Enver Hoxha lëshoi urdhrin për kalimin

xhandarë, ballistë e zogistë, gjithsej 50 mijë veta. Mësymjen e re të përgjithshme komanda e trupave gjermane të pushtimit kishte llogaritur ta zhvillonte me anën e një operacioni të vetëm, që duhej të zgjaste dy javë, të shumtën deri një muaj. Mirëpo UNÇSH tok me popullin kryengritës, të përgatitur me kohë nga çdo pikëpamje për t'i bërë ballë një mësymjeje të re të përgjithshme të armiqve, ua shkatërruan atyre planin, siç ua patën shkatërruar edhe në dimrin 1943-1944.

Nga 28 maji deri më 10 qershor mësymja armike u zhvillua në zonën Korçë—Elbasan—Berat—Përmet. Hitlerianët e reaksionarët u ndeshën në qëndresën e ashpër të Divizionit I dhe të njërive e të reparteve të tjera të UNÇSH. Partizanët kalonin nga mbrojtja në kundërsulme të furishme mbi armiqtë dhe shpesh shfarosnin kolona dhe reparte të tëra gjermanësh e tradhtarësh. Divizioni I Sulmues, i bllokuar nga forcat gjermane në Tomoricë, çau rrethimin dhe vetëm brenda disa ditëve i rifitoi të gjitha pozitat e humbura.

Nga 10 deri më 24 qershor mësymja armike u zhvillua në territorin e Zonës I Operative Vlorë—Gjirokastrë. Për repartet partizane që vepronin në këtë zonë u krijua një gjendje e rëndë dhe e rrezikshme. Ato u rrethuan nga çdo anë prej trupave hitleriane. Por, falë trimërisë së partizanëve dhe udhëheqjes së guximshme të komandantëve dhe komisarëve, forcat partizane manovruan me mjeshtëri dhe e çanë rrethimin e armikut.

Mësymja e përgjithshme armike e qershorit 1944 shërbeu si një provë tjetër e madhe e forcës së pathyeshme të Ushtrisë Nacionalçlirimtare e të popullit shqiptar. Nga kjo mësymje ushtria popullore doli më e rritur dhe më e fortë, populli doli më i vendosur për të vazhduar luftën deri në fitore, me besim edhe më të thellë tek udhëheqja e Partisë Komuniste.

Kryesorja në ato rrethana ishte të ruheshin forcat e gjalla, kompaktësia dhe aftësia luftarake e Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe të mos pengohej zbatimi i planit operativ-strategjik të Shtabit të Përgjithshëm. Urdhri i mësymjes së Divizionit I Sulmues përtej Shkumbinit mbetej gjithnjë në fuqi. Në gjendjen konkrete Komanda e Përgjithshme e shikonte kalimin e divizionit në Shqipërinë e Mesme si një masë me rëndësi të jashtëzakonshme strategjike. Në kohën që tru-



pat gjermane ishin duke vazhduar veprimet e tyre luftarake në jug të Vjosës, ajo nxori si përfundim se ishte çasti më i volitshëm që Divizioni I të fillonte zbatimin e urdhrin që kishte marrë.

### **Mësymja e përgjithshme e UNÇSH, asgjësimi i planeve të reaksionit të brendshëm e të jashtëm**

Divizioni I Sulmues kaloi Shkumbinin dhe u hodh në mësymje

më 25-26 qershor 1944. Armiqtë, të kapur në befasi, nuk qenë në gjendje t'i bënin ballë këtij grushti. Forcat e divizionit në bashkëveprim me repartet partizane territoriale u futën thellë në Shqipërinë e Mesme dhe vazhduan pa u ndalur marshimin drejt Dibrës. Deri nga mesi i korrikut ishin çliruar të gjitha krahinat që caktoheshin në urdhrin e Komandantit të Përgjithshëm. Populli i Shqipërisë së Mesme dhe i qarkut të Dibrës i dha përkrahje të fuqishme Divizionit I dhe tok me të u ngrit në luftë kundër skllavëruesve gjermanë e tradhtarëve. Në brigadat e divizionit u futën mijëra vullnetarë të rinj të krahinave të porsaçliruara, kurse repartet e vogla partizane që vepronin në zonat e kontrolluara nga armiqtë në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut u rritën menjëherë në batalione dhe pas një kohe të shkurtër u kthyen në brigada të UNÇSH.

Kaq e papritur ishte për pushtuesit dhe tradhtarët mësymja e Divizionit I Sulmues në Veri, sa që në fillim pandehën se kishin të bënin me «mbeturina» të forcave partizane të shpartalluara në Jug që kalonin aty për të gjetur shpëtim. Por shumë shpejt e kuptuan të vërtetën. Të alarmuar në kulm, ata filluan të tërhiqnin me nxitim trupa nga Jugu në Veri për të shkatërruar Divizionin I Sulmues.

Kundër Divizionit armiqtë ndërmorën dy operacione njërin pas tjetrit, në korrik dhe gusht 1944. Që të dy dështuan krejt. Luftëtarët e UNÇSH i shpartalluan forcat hitleriane e reaksionare dhe çliruan përfundimisht gjithë qarkun e Dibrës me qytetet e Peshkopisë e të Dibrës dhe një pjesë të Mirditës.

Zhvillimi me sukses i mësymjes së Divizionit I të UNÇSH nuk u ndalua as nga presioni i komandës së forcave anglo-amerikane të Mesdheut, e cila disa herë me radhë kërkoi në mënyrë kërcënuese ndërprerjen e veprimeve luftarake kundër forcave të tradhtarit Abaz Kupi, duke pretenduar se partizanët ndërhyjnë në planet e saj strategjike! Komanda

nda e Përgjithshme e Ushtrisë Nacionalçlirimtare i hodhi poshtë kërkesat e kërcënimit e aleatëve anglo-amerikanë dhe plotësoi pa ngurrim detyrën e ngarkuar nga Komiteti Qendror i Partisë dhe Kongresi i Përmetit.

Në gusht u krijua Divizioni II Sulmues, i cili kaloi menjëherë në mësymje bashkë me Divizionin I kundër trupave pushtuese gjermane dhe bandave tradhtare në Shqipërinë e Veriut. Të dy divizionet dhe gjithë forcat partizane në Shqipërinë e Mesme e të Veriut, me përjashtim të Grupit të Pezës, u përfshinë në Korparmatën I të UNÇSH. Komiteti Qendror i Partisë ngarkoi me detyrën e komisarit politik të korpamatës shokun Hysni Kapo, anëtar i KQ të PKSH.

Ndërkaq në Shqipërinë e Jugut ishin hedhur në mësymje të përgjithshme njësitë e tjera të Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Ardhja në gusht e misionit ushtarak sovjetik në Shqipëri, në përgjigje të kërkesës që bëri Kongresi i Përmetit, u vlerësua nga PKSH si një ndihmë që Bashkimi Sovjetik i jepte luftës çlirimtare të popullit shqiptar dhe një njohje e sovranitetit të tij. Kjo dëshmonte gjithashtu për miqësinë e aleancën revolucionare midis popullit shqiptar dhe popujve sovjetikë, të farkëtuara në luftën e përbashkët kundër fashizmit.

Mbarë toka shqiptare, nga një skaj në tjetrin, ishte një vullkan i zjarrtë. Garnizonet gjermane, bandat reaksionare dhe vijat e komunikacionit të armikut u qenë nënshtruar goditjeve të përditshme shkatërruese të UNÇSH. Armiqtë, në pamundësi për t'i bërë ballë mësymjes së saj të përgjithshme, lëshonin njëra pas tjetrës krahinat dhe qytetet e pushtuara prej tyre. Që nga 24 tetori gjithë pjesa jugore e vendit ndodhej krejt e spastruar nga hitlerianët. Në veri të Shkumbinit pushtuesit gjermanë vazhdonin të mbanin ende vetëm qytetet Elbasan, Tiranë, Durrës, Kukës dhe Shkodër.

Dy Brigada të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare (V dhe III), me kërkesën e Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Jugosllave, që nga 5 tetori kishin kaluar kufirin shtetëror për të vepruar kundër nazistëve gjermanë në Kosovë.

Përveç çlirimit të pjesës më të madhe të atdheut dhe dëmeve të mëdha që iu shkaktuan trupave gjermane, një nga pasojat më të rëndësishme të muajve të parë të mësymjes së

përgjithshme të UNÇSH ishte shpartallimi i plotë i reaksionit të brendshëm. Balli Kombëtar, Legaliteti, bandat e tyre të armatosura dhe repartet e xhandarëve u shkatërruan nën grushtet e brigadave dhe divizioneve sulmuese. Regjenca me qeverinë kuislinge u paralizuan krejt.

Një orvatje e re që bënë oficerët britanikë për të formuar një qeveri kukull shqiptare me pjesëmarrjen e krerëve të reaksionit, si kundërmasë ndaj qeverisë së përkohshme revolucionare, nuk dha asnjë fryt.

Mbeturinat e forcave reaksionare, të grumbulluara rreth krerëve të tyre, nën mbrojtjen e ushtrisë gjermane, të vetmen shpresë të shpëtimit e kishin vënë në një zbarkim të mundshëm të trupave anglo-amerikane në Shqipëri dhe në përkrahjen nga ana e këtyre trupave.

Por edhe kjo shpresë e fundit e tradhtarëve nuk u plotësua. Komanda e Përgjithshme e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, duke zbatuar me besnikëri direktivat e Komitetit Qendror të Partisë, i hodhi poshtë me vendosmëri të gjitha kërkesat e përsëritura të komandës anglo-amerikane të Mesdheut për të sjellë në Shqipëri trupa parashutiste dhe speciale gjoja për të luftuar së bashku kundër gjermanëve. UNÇSH ishte e aftë të çlironte krejt vendin me forcat e veta dhe s'kishte nevojë për ndihmë të forcave të armatosura të jashtme. Kur komandot<sup>1</sup> angleze hynë në Sarandë pas asgjësimit të garnizonit hitlerian nga brigadat e UNÇSH, Komanda e Përgjithshme e detyroi shtabin britanik të largonte pa vonesë forcat e veta nga bregdeti shqiptar.

U mënjanua kështu rreziku i madh që paraqiste për fitoren e revolucionit popullor një zbarkim i trupave anglo-amerikane në Shqipëri. Komiteti Qendror i Partisë, Sekretari i Përgjithshëm i saj e Komandanti i Përgjithshëm i UNÇSH, Enver Hoxha, treguan pjekuri, urtësi e guxim revolucionar përpara presionit të fortë e të vazhdueshëm të aleatëve anglo-amerikanë dhe nuk i lejuan në asnjë rast të përziheshin në punët e brendshme të popullit shqiptar. Një qëndrim i tillë parimor konsekuent dhe vrulli revolucionar i luftës i asgjësuan të gjitha orvatjet që bënë qeveritë e Britanisë së Madhe e të SHBA si edhe misionet e tyre ushtarake në Shqipëri për të shtënë në dorë drejtimin e Lëvizjes Nacionalçlirimtare

---

1 Trupa speciale zbarkimi.

shqiptare, për të shkatërruar Frontin e Partinë Komuniste dhe për të pushtuar vendin me anë të zbarkimit të forcave të tyre të armatosura.

## **Përforcimi i themeleve të demokracisë popullore**

Çlirimi i pjesës më të madhe të vendit krijoi mundësinë për zgjerimin dhe forcimin e pushtetit popullor, për gjallërimin, si kurrë ndonjëherë, të veprimtarisë së këshillave nacionalçlirimtarë. Komiteti Antifashist, krahas detyrave në dobi të luftës së armatosur kundër pushtuesve, kryente një veprimtari të gjerë për organizimin e rendit shtetëror dhe shoqëror, për rimëkëmbjen e vendit të shkatërruar, për ngritjen e ekonomisë, për zhvillimin e tregtisë. Në të gjitha krahinat dhe qytetet e çliruara u gjallërua jeta ekonomike. Çetat dhe batalionet e punës iu përveshën ndërtimit të urave dhe rrugëve të shkatërruara, të shkollave dhe shtëpive të djegura. U çelën shkollat dhe u organizua shërbimi shëndetësor. Kryesitë e këshillave vunë nën qeverisjen e tyre të gjitha objektet me rëndësi të veçantë ekonomike dhe materialet e ndërtimit.

Komiteti Antifashist mori vendim për konfiskimin e pasurisë së tundshme e të patundshme të tradhtarëve. Ai dha udhëzime për regjistrimin e tokave dhe përgatitjen e statistikës mbi tokën e punueshme e bagëtinë, mbi zotërimin e tyre dhe mbi numrin e fshatarëve pa tokë. Kjo që masa e parë përgatitore për reformën agrare, e cila do të kryhej menjëherë pas çlirimit të vendit.

Masat popullore mbështetën me të gjitha forcat veprimtarinë e Komitetit Antifashist dhe të këshillave nacionalçlirimtarë. Duke treguar besnikërinë ndaj Komitetit Antifashist, ato kërkonin që ai të merrte menjëherë emrin e vërtetë si Qeveri Demokratike e Shqipërisë. Kjo kërkesë diktohej nga rritja e autoritetit të Komitetit si qeveria e vetme e popullit shqiptar dhe nga fakti që çlirimi i plotë i Shqipërisë tani ishte fare i afërt.

Kjo çështje u shqyrtua në Mbledhjen e Dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar që zhvilloi punimet më 20-23 tetor 1944 në qytetin e lirë të Beratit.

Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar vendosi njëzëri shndërrimin e Komitetit Antifashist në **Qeveri Demokratike të Shqipërisë**. Në programin e vet që u miratua nga Mbledh-

ja e Këshillit, Qeveria Demokratike zotohej përpara popullit shqiptar të zbatonte me besnikëri vendimet e Kongresit të Përmetit. Ajo merrte përsipër të zhvillonte e të forconte më tej luftën për çlirimin e shpejtë e të plotë të Shqipërisë, të ruante pavarësinë e shtetit shqiptar, të forconte pushtetin e këshillave nacionalçlirimtarë, të siguronte e të mbronte të drejtat e qytetarëve. Qeveria do të rishikonte marrëveshjet politike, ushtarake dhe ekonomike, të përfunduara nga regjimi i Zogut me shtetet e huaja, dhe do të prishte të gjitha ato që dëmtonin interesat e popullit dhe të shtetit shqiptar. Në programin e saj parashikohej gjithashtu vendosja e marrëdhënieve dhe e bashkëpunimit të ngushtë me Bashkimin Sovjetik dhe me gjithë pjesëmarrësit e koalicionit antifashist. Qeveria detyrohej të organizonte pas Çlirimit të vendit zgjedhje demokratike për Asamblenë Kushtetuese, e cila do të përcaktonte përfundimisht formën e regjimit dhe do të hartonte Kushtetutën e shtetit të ri shqiptar.

Mbledhja e Beratit pranoi ligjin mbi këshillat nacionalçlirimtarë si edhe ligjin mbi zgjedhjet e këshillave. Deri në këtë kohë këshillat kishin qenë edhe organe të pushtetit edhe organe të Frontit Nacionalçlirimtar. Këtej e tutje ato do të kryenin detyra vetëm si organe të pushtetit demokratik popullor. Fronti do të krijonte organizatat e tij më vete.

Një nga vendimet më të rëndësishme të Mbledhjes së Beratit ishte pranimi i «Deklaratës mbi të drejtat e qytetarëve». Me anë të saj u siguroheshin të gjithë shtetasve të drejta të barabarta përpara ligjit: liria e mbledhjes, e fjalës, e shoqërimit, e shtypit, liria e fesë dhe e ndërgjegjes, barazia e të drejtave të gruas me të burrit, e drejta e zgjedhjes që nga mosha 18 vjeç, e drejta e ankimit etj. «Deklarata mbi të drejtat e qytetarëve» përbënte një dokument kushtetues të shtetit të ri të demokracisë popullore.

Vendimet e Mbledhjes së Dytë të KANÇ ishin plotësimi dhe konkretizimi i mëtejshëm i vendimeve historike të Kongresit të Përmetit dhe shënonin një fitore të re politike të popullit shqiptar mbi fashizmin dhe reaksionin e brendshëm. Ato qenë një grusht tjetër kundër orvatjeve të imperialistëve anglo-amerikanë për të vendosur kontrollin e tyre në Shqipëri.

Lufta revolucionare nën udhëheqjen e Partisë Komuniste e kishte përparë me gjithë rrënjë pushtetin kuisling çifligaroborgjez.

Në kohën që mbahej Mbledhja e Beratit, UNÇSH ishte shndërruar e tëra në ushtri të rregullt të popullit dhe të shtetit të ri shqiptar. Ajo kishte tani në gjirin e saj 70 mijë luftëtarë, të organizuar në brigada, divizione dhe korparmata. Prej tyre 9 për qind ishin gra, rreth 80 për qind të rinj dhe afër 90 për qind fshatarë.

Njësitë e Ushtrisë Nacionalçlirimtare zhvillonin operacionet e fundit kundër trupave gjermane në Shqipëri dhe në Kosovë. Nga këto më i rëndësishmi ishte operacioni për çlirimin e Tiranës. Urdhri i Komandantit të Përgjithshëm ishte të asgjësohej armiku, të ndalohej grabitja dhe shkatërrimi i qytetit nga gjermanët e të çlirohej Tirana me çdo kusht. Udhëheqja e operacionit iu ngarkua Komandës së Korparmatës I. Luftimet në kryeqytet dhe në rajonin përreth i drejtonte komandanti i Divizionit I, [REDACTED].

Operacioni për çlirimin e kryeqytetit zgjati 19 ditë. Më 17 nëntor u ngrit flamuri i fitores në Tiranë. Ky operacion tregoi shkallën e lartë të organizimit, të disiplinës dhe të moralit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Në luftën për çlirimin e Tiranës së bashku me brigadat sulmuese mori pjesë gjallërisht populli i qytetit.

Ndërkaq forcat e UNÇSH përtej kufirit shtetëror në bashkëveprim me brigadat kosovare, deri më 18 nëntor, kishin spastruar nga trupat hitleriane krejt Rrafshin e Dukagjinit duke çliruar me luftë të ashpër Junikun, Deçanin, Gjakovën, Prizrenin e Pejën dhe duke u shtrirë në pjesën më të madhe të Kosovës.

### **Ndërhyrja brutale e udhëheqjes së PK Jugosllave në punët e brendshme të PKS**

Në pragun e çlirimit të plotë të vendit, më 23 nëntor, në Berat u mbledh Plenumi i 2-të i Komitetit Qendror të PKS. Në këtë kohë Partia ishte rritur në rreth 2 800 anëtarë. Mbledhja e Plenumit ishte e nevojshme për të bërë bilancin e punës dhe të fitoreve të Partisë e të popullit në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe për të përcaktuar detyrat në etapën e re të revolucionit që fillonte me çlirimin e Shqipërisë.

Por punimet e Plenumit morën një zhvillim krejt të shtrembër për shkak të ndërhyrjes brutale të udhëheqjes së Partisë

Komuniste të Jugosllavisë (PKJ) në punët e brendshme të Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore ndërmjet popullit shqiptar dhe popujve të Jugosllavisë, që zhvillonin një luftë heroike kundër armikut të përbashkët, pushtuesve fashistë, u krijuan marrëdhënie vëllazërore luftarake. Midis PKSH dhe PKJ u vendosën lidhje të ngushta.

Me kërkesën e KQ të PKJ, një numër kuadrosht të PKSH u dërguan për të organizuar partinë dhe luftën kundër pushtuesve fashistë në Kosovë. Në qytetet e Dibrës, të Gostivarit, të Tetovës, të Kërçovës dhe në rrethet e tyre jepte një ndihmë të madhe në organizimin e luftës çlirimtare organizata e PKSH e Qarkut të Dibrës.

Për të mbajtur lidhje në mes dy partive qëndroi në Shqipëri Miladin Popoviçi, komunist internacionalist jugosllav, të cilin komunistët shqiptarë e patën liruar në vjeshtë të vitit 1941 nga një kamp përqendrimi fashist në Peqin. Në marrëdhëniet ndërmjet PKSH dhe PKJ ai ka përkrahur gjithnjë qëndrimin internacionalist të KQ të PKSH<sup>1</sup>.

Lidhjet e ngushta që u krijuan midis popullit shqiptar dhe popujve të Jugosllavisë udhëheqja e PKJ u mundua t'i shfrytëzonte për t'i diktuar PKSH vullnetin e vet dhe për të vënë në jetë synimet shoviniste kundrejt Shqipërisë.

Në verë të vitit 1943 Vukmanoviç-Tempoja, një nga udhëheqësit kryesorë të PKJ, i cili kishte ardhur në Shqipëri me mision të posaçëm për të krijuar «shtabin ballkanik»<sup>2</sup>, paditi në mënyrë krejt të palejueshme dhe të padrejtë Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë për qëndrim oportunist ndaj Ballit Kombëtar. Kjo shpifje trashanike bëhej

---

1 Miladin Popoviçi u largua nga Shqipëria në shtator 1944, me urdhër të udhëheqjes së PKJ, kurse në mars 1945 u vra në Prishtinë në një atentat të kurdisur nga shërbimi i fshehtë jugosllav.

2 Krijimi i «shtabit ballkanik» u ndërmor me iniciativën e Titos. Me këtë udhëheqja jugosllave synonte të vinte nën komandën e vet forcat e armatosura çlirimtare të Greqisë, të Shqipërisë dhe të Bullgarisë. Orvatjet për krijimin e «shtabit ballkanik» nuk patën sukses për shkak të kundërshtimit që u has në partitë komuniste të Ballkanit.

*Elo*  
*Elo*

*Elo*

*Elo*

PKSH që të krijohej mendimi se gjoja KQ i jendje të drejtonte në mënyrë të pavarur, se ai nuk munda të mos gabonte rëndë pa marrë direktiva nga «udhëheqja me përvojë» e Partisë Komuniste të Jugosllavisë!

Kjo akuzë djallëzore u hodh poshtë në atë kohë nga Komiteti Qendror i PKSH si krejt e pathemeltë. Megjithatë orvatja e parë e udhëheqjes jugosllave për të nënshtuar PKSH nuk kaloi pa lënë gjurmë. Koçi Xoxe, anëtar i Byrosë Politike të Komitetit Qendror, dhe Sejfulla Malëshova, kandidat i Komitetit Qendror, e përkrahën pikëpamjen e shtrembër të Tempos dhe treguan gatishmëri për t'iu nënshtuar vijës dhe urdhrave të udhëheqësve shovinistë jugosllavë. Që nga kjo kohë Koçi Xoxja filloi t'i shërbente në të vërtetë udhëheqjes jugosllave me cilësinë e agjentit të saj në PKSH.

Konceptin e vet shovinist Vukmanoviç-Tempoja e shfaqti në mënyrë të theksuar në vjeshtë të vitit 1943. I mbrujtur me këtë koncept, ai e vlerësonte si një rrezik veprimtarinë me të vërtetë internacionaliste të organizatës së PKSH të qarkut të Dibrës në qytetet dhe krahinat përtej kufirit të banuara prej shqiptarësh e maqedonasish, si edhe autoritetin e madh që gëzonte kjo organizatë dhe shtabi i qarkut të Dibrës në popullsinë e atjeshme. Nga Maqedonia Vukmanoviç-Tempoja me një egërsi të papërmbajtur i shkroi dy letra njëren pas tjetrës Komitetit Qendror të PKSH. Në to ai padiste si «shovinistë deri në pakufi» dhe «shqiptaromëdhenj» komunistët e partizanët shqiptarë, komandantin e shtabit të qarkut, Haxhi Lleshin, dhe vetë Komitetin Qendror të PKSH. Në mënyrë brutale ai kërkonte që gjithë partizanët shqiptarë që banonin në Jugosllavi të largoheshin nga batalionet e UNÇSH të qarkut të Dibrës dhe të viheshin nën komandën e shtabit jugosllav; që Haxhi Lleshi të largohej nga qyteti i Dibrës dhe të vinte aty vetëm kur ta thërriste shtabi jugosllav për ndihmë; që Këshilli Nacionalçlirimtar i Dibrës të shkëpuste lidhjet me shtabin shqiptar e të vihej nën varësi të shtabit jugosllav. «Përndryshe, — kërcënonte Tempoja, — do të ndodhë përleshja, ku do të marrin pjesë dhe komunistët»(!)

Komiteti Qendror i PKSH, i fyer thellë nga një ndërhyrje e tillë e palejueshme, i flaku poshtë shpifjet dhe paditë e Tempos, duke shprehur habinë më të madhe për tonin aq



të ashpër e aspak komunist të letrave të tij dhe për trillimet aq të përbindshme. Në të njëjtën kohë ai e paralajmëroi Tempon se nuk pranonte në asnjë mënyrë që njerëz të jashtëm t'u jepnin urdhra reparteve partizane shqiptare dhe t'i diktonin vullnetin e vet Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Shfaqje të theksuara shoviniste viheshin re ndër drejtues jugosllavë ushtarakë e të partisë edhe në Kosovë. Ata nuk merrnin parasysh vullnetin e popullsisë shqiptare dhe e luftonin me mënyra të ndryshme idenë e përhapur aq shumë gjatë luftës mbi vetëvendosjen e popujve, kryenin shpesh veprime diskriminuese dhe shfarosjeje të shqiptarëve në Kosovë e në Mal të Zi, sikundër edhe çetnikët e Mihajloviçit. Komiteti Qendror i PKSH dhe organizatat e partisë për Shkodrën dhe Tropojën patën bërë disa herë vërejtje dhe patën kritikuar qëndrimet shoviniste të drejtuesve të ndryshëm jugosllavë, si qëndrime që pengonin shumë zhvillimin e luftës kundër pushtuesve italianë e gjermanë në Kosovë.

Ndërkaq Partia Komuniste e Shqipërisë mbante një qëndrim konsekuent internacionalist, nuk i lejonte vetes asnjë shfaqje sado të vogël shoviniste, ndihmonte me të gjitha forcat zhvillimin e luftës antifashiste në Kosovë, luftonte për vëllazërimin mbi baza marksiste-leniniste të popullit shqiptar me popujt e Jugosllavisë. Lidhur me problemin e Kosovës dhe të krahinave të tjera të banuara prej shqiptarësh në Jugosllavi, PKSH nuk e kishte pranuar asnjëherë parullën fashiste të «Shqipërisë së madhe». Ajo e shikonte zgjidhjen e drejtë të këtij problemi në fitoren e revolucionit popullor si në Shqipëri dhe në Jugosllavi. PKSH kishte shpallur botërisht se populli kosovar me fitoren e revolucionit në të dy vendet do të fitonte të drejtën të vendoste vetë mbi fatin e tij. Në rast të kundërt ai do të luftonte kundër asaj Jugosllavie që do të përpiqej ta shtypte e ta robëronte.

Në atë kohë Partia Komuniste e Shqipërisë ende nuk dyshonte që udhëheqja e PKJ të ushqente qëllime shoviniste, sepse nuk mund ta merrte me mend se si udhëheqësit e një partie që e quan veten marksiste-leniniste, të kishin qëllime të atilla, të cilat i kanë vetëm partitë socialshoviniste, imperialistët dhe veglat e tyre. Ajo kujtonte se shfaqjet shoviniste të Tempos dhe të disa drejtuesve të partisë dhe të reparteve partizane të Serbisë e të Maqedonisë në kohën e luftës ishin shtrembërime

që kryheshin nga njerëz të veçuar dhe jo veprime që shprehnin politikën e PKJ.

Në vitin 1944 u shtua edhe më shumë presioni i Komitetit Qendror të PKJ mbi PKS. Ai mundohet me mënyra të ndryshme që të përgatitet opinioni në popullin shqiptar se çdo gjë, edhe krijimi i PKS, edhe Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare i detyroheshin «ndihmës» së Partisë Komuniste Jugosllave, Titos, që Shqipëria e re duhet ta shikonte të ardhmen e saj të lidhur me fatin e Jugosllavisë dhe vetëm të Jugosllavisë!

Kjo politikë antimarksiste e udhëheqjes jugosllave ndeshi në kundërshtimin e drejtë të PKS.

Pengesë kryesore për zbatimin e planit të saj në Shqipëri udhëheqja jugosllave quante vijën marksiste-leniniste të PKS, Sekretarin e Përgjithshëm, Enver Hoxhën, dhe anëtarë të tjerë të KQ që e mbrojnë me vendosmëri këtë vijë e nuk pranonin ndërhyrje të jashtme në punët e brendshme të Partisë e të vendit.

KQ i PKJ u mundua ta kapërcente këtë pengesë në Plenumin II të KQ të PKS, në nëntor 1944.

Për të arritur qëllimin e vet, udhëheqja jugosllave dërgoi posaçërisht në Shqipëri Velimir Stojnićin me cilësinë e shefit të misionit ushtarak jugosllav dhe të ndërlidhësit midis PKJ e PKS. Me të ardhur këtu, Velimir Stojnić filloi sulmin kundër vijës së përgjithshme të PKS, duke e quajtur atë një vijë kryekëput të gabuar dhe duke kërkuar që të bëheshin pa vonesë ndryshime rrënjësore si në vijë, ashtu dhe në udhëheqje. Kjo akuzë shpifëse dhe kjo ndërhyrje në punët e brendshme të Partisë u kundërshtuan nga Sekretari i Përgjithshëm, shoku Enver Hoxha, por në të njëjtën kohë u përkrahën nga anëtarët e Byrosë Politike Koçi Xoxe dhe Nako Spiru.

Sulmi i pabesë i udhëheqjes jugosllave gjeti një mbështetje të fortë në Byronë Politike të KQ të PKS, sidomos me kooptimin, jashtë rregullave organizative, si anëtarë të saj të Sejfulla Malëshovës dhe Pandi Kristos dhe me sigurimin në këtë mënyrë të shumicës projugosllave në Byro.

Me këta karrieristë e ambiciozë, fshehtazi Komitetit Qendror dhe Sekretarit të Përgjithshëm, Velimir Stojnić përpunoi platformën me të cilën do të dilej në Plenum kundër vijës marksiste-leniniste të sprovuar të PKS.

Flamurin e sulmit antiparti në Plenum e mbajtën në dorë Sejfulla Malëshova dhe përfaqësuesi jugosllav<sup>1</sup>, të përkrahur plotësisht nga Koçi Xoxja dhe pjesëtarët e tjerë të komplotit të fshehtë.

Partia Komuniste e Shqipërisë, që kishte luftuar me aq heroizëm dhe kishte arritur fitore vendimtare në luftën revolucionare, u cilësua nga komplotistët «një parti komuniste jo e vërtetë», me «një vijë dhe një udhëheqje jomarksiste-leniniste». Rruga e saj e lavdishme, e sprovuar në zjarrin e luftës, që çoi në çlirimin e atdheut dhe në vendosjen e pushtetit popullor u errësua si «një rrugë plot gabime dhe shtrembërime» që luhatej vazhdimisht «nga sektarizmi në oportunitizëm dhe vice versa». Enver Hoxha, themeluesi dhe mësuesi i Partisë, udhëheqësi dhe heroi i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, u paraqit nga renegatët si «sinteza e të gjitha gabimeve». Sejfulla Malëshova ngriti nevojën e «kryetarit të partisë», vend që duhej ta zinte një njeri «me përgatitje të thellë teorike» (!), duke pasur parasysh veten.

Velimir Stojniçi e cilësoi punën e Miladin Popoviçit në Shqipëri si një veprimtari të gabuar që nuk pranohej nga udhëheqja e PKJ dhe paraqiti «vijën e re» që kjo «i rekomandonte» Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Duke e quajtur sektare punën që bëhej për popullarizimin e PKSH si udhëheqëse e popullit shqiptar, ai ngriti çështjen që në të ardhmen të mos popullarizohej Partia si e tillë, por Fronti. Ai kërkoi që në organet drejtuese të Frontit të tërhiqeshin përfaqësuesit me ndikim të borgjezisë reaksionare e të klerit të lartë, pa marrë parasysh qëndrimin e tyre armiqësor në Luftën Nacionalçlirimtare. Rekomandime të tilla të udhëheqjes jugosllave përputheshin me planet e imperialistëve anglo-amerikanë, të cilët bënin presion mbi Qeverinë Demokratike të Shqipërisë që të pranonte në përbërjen e saj dhe në Këshillin Antifashist përfaqësues të reaksionit, për t'i përdorur më vonë si mbështetje në përmbysjen e pushtetit popullor.

---

<sup>1</sup> Velimir Stojniçi u ftua të merrte pjesë në mbledhjen e Plenumit si përfaqësues i një partie motër. Duke pasur përkrahjen e komplotistëve në gjirin e KQ të PKSH, ai ndërhyri brutalisht në punët e brendshme, duke shkëlur të gjitha rregullat e marrëdhënieve midis partive komuniste.

Delegati jugosllav e errësoi krejt veprimtarinë e këshillave nacionalçlirimtarë, të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, të komisarëve politikë dhe kërkoi që ushtria të pajisej me një «kokë të fortë politike» e me «një komandë të fortë ushtarake». Në mënyrë të posaçme ai u përqendrua në marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare mbi bazën e «vëllazërimit ballkanik». «Shqipëria, — deklaroi Velimir Stojniçi, — nuk mund të ndërtojë ekonominë dhe të zhvillohet në mënyrë të pavarur, ajo është një kafshatë e vogël për imperializmin», prandaj «nuk ka tjetër rrugë veçse të lidhet me Jugosllavinë në një konfederatë, bile edhe më tutje»! Për të arritur këtu, ai e quajti të domosdoshme të përgatiteshin masat popullore shqiptare për këtë lidhje dhe të popullarizohej Titoja si «simbol i çlirimit të popujve të Ballkanit e të Evropës»<sup>1</sup>.

Detyrat e ngutshme që i dëlnin PKSH për zhvillimin më tej të revolucionit pas çlirimit të vendit u mbytën në Plenum nga sulmet e komplotistëve kundër vijës së përgjithshme të Partisë dhe kështu nuk u rrahën pothuajse fare. Delegati jugosllav e Sejfulla Malëshova deklaruan se Shqipëria edhe për një kohë të gjatë «nuk do të zhvillojë revolucionin socialist dhe nuk do të shkojë në socializëm»!

Duke mos ditur asgjë për komplotin e organizuar në prapaskenë dhe për qëllimet djallëzore të udhëheqjes jugosllave, një numër anëtarësh dhe kandidatësh të Komitetit Qendror shfaqën lëkundje të theksuara në Plenum dhe pranuan deri në një shkallë tezat e të dërguarit jugosllav dhe të grupit antiparti.

Në këtë mënyrë, mbledhja e Plenumit të 2-të të KQ të PKSH u minua nga KQ i PKJ. Aty u dhanë orientime dhe u morën vendime në dëm të interesave të Partisë e të popullit shqiptar.

I vetmi vendim i drejtë që mori Plenumi ishte përjashtimi i Liri Gegës nga radhët e Komitetit Qendror për sektarizëm dhe aventurizëm të theksuar. Por komplotistët pa asnjë bazë dhe me qëllim të caktuar ia veshën këtë gjithë vijës së Partisë dhe përcaktuan si rrezik kryesor për PKSH sektarizmin! Në Plenum u vendos që Komiteti Qendror të shtohet me 7 anëtarë dhe 11 kandidatë të rinj.

---

<sup>1</sup> Procesverbal i Plenumit të 2-të të KQ të PKSH, nëntor 1944. AQP.

Plenumi i Beratit i dha një grusht të rëndë unitetit në udhëheqjen e Partisë. U çel rruga për të futur në Parti forma organizative dhe metoda antileniniste, revizioniste të udhëheqjes jugosllave. U krijua truall i përshtatshëm për ndërhyrjen në shkallë të gjerë të revizionistëve jugosllavë në punët e brendshme të Partisë e të vendit.

Komploti i titistëve në Berat nuk ia arriti plotësisht qëllimit për arsye të qëndresës së vendosur të shokut Enver Hoxha dhe të anëtarëve të tjerë të Komitetit Qendror që mbrojtën vijën marksiste-leniniste të Partisë. Udhëheqja jugosllave nuk ia arriti dot qëllimit kryesor të rrezonte Sekretarin e Përgjithshëm, sepse shumica e anëtarëve të Plenumit e hodhi poshtë kërkesën e komplotistëve për ta larguar atë nga kjo detyrë dhe ngritën lart meritat e mëdha të shokut Enver Hoxha si themelues i PKSJ dhe udhëheqës i saj dhe i Luftës Nacionalçlirimtare. Megjithatë, ky komplot përbënte orvatjen e parë për të minuar themelet e partisë marksiste-leniniste shqiptare, krijonte një rrezik të madh për pavarësinë e Shqipërisë dhe për revolucionin popullor.

Në kohën që Plenumi i 2-të i KQ të PKSJ zhvillonte punimet e tij në Berat, Ushtria Nacionalçlirimtare po i jepte fund spastrimit të tokës shqiptare nga pushtuesit nazistë. Duke e ndjekur këmba-këmbës dhe duke e shkatërruar armikun, më 29 nëntor ajo çliroi qytetin e fundit, Shkodrën, dhe mbarë Shqipërinë. Në gjithë vendin tani ishte vendosur pushteti i demokracisë popullore. **29 Nëntori 1944 shënon çlirimin e plotë të atdheut dhe fitoren e revolucionit popullor.**

Menjëherë pas Çlirimit të Shqipërisë me vendim të KQ të PKSJ dhe me urdhër të Komandantit të Përgjithshëm, Enver Hoxhës, dy divizione të UNÇSH (V dhe VI) vazhduan ndjekjen e trupave hitleriane në Jugosllavi. Luftëtarët shqiptarë dhe luftëtarët jugosllavë, duke luftuar krah për krah kundër hordhive naziste, në dhjetor 1944 dhe janar-shkurt 1945 çliruan Malin e Zi, Sanxhakun dhe pjesën jugore të Bosnjës. Me qëndrimin e tyre thellësisht internacionalist, me edukatën komuniste dhe me heroizmin e pashoq në luftë, partizanët shqiptarë fituan zemrat dhe nderimin e thellë si të popullsisë shqiptare, ashtu dhe të popullsisë maqedonase, malazeze dhe sanxhakase në Jugosllavi. Në luftimet për çlirimin e popujve të Jugosllavisë dhanë jetën qindra luftëtarë të UNÇSH.

## 10. BILANCI I LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE DHE SHKAQET E FITORES

Lufta Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve italianë e gjermanë dhe kundër tradhtarëve, që vazhdoi më se pesë vjet e gjysmë, është lufta më burrërore e më ngadhënjimtare që kanë bërë shqiptarët gjatë historisë së tyre.

Populli shqiptar prej 1 milion vetash gozhdoi në luftë më se 15 divizione italiane e gjermane dhe nxori jashtë luftimit rreth 70 mijë armiq të vrarë, të plagosur e robër. Si një nga pjesëtarët më veprues të koalicionit botëror antifashist, Shqipëria, në krahasim me madhësinë e territorit e të popullsisë së saj, dha në të njëjtën kohë një kontribut të çmueshëm në fitoren historike mbi fashizmin. Ajo mbajti mbi supet e veta një barrë mjaft të rëndë. Në truallin shqiptar prej 28 mijë km<sup>2</sup> gjatë Luftës së Dytë Botërore shkeli këmba e rreth 700 mijë ushtarëve fashistë, të cilët shkaktuan dëme dhe rrënimë të jashtëzakonshme. Shqipëria zë një nga vendet e para për humbje në njerëz dhe sidomos në të mira materiale gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Përppjekjet heroike, gjaku dhe humbjet e mëdha të popullit shqiptar në luftë u kurorëzuan me fitoren përfundimtare mbi armiqtë e jashtëm e të brendshëm.

Më 29 Nëntor 1944, me çlirimin e plotë të atdheut dhe me triumfin e revolucionit popullor, në Shqipëri mori fund sundimi fashist, njëkohësisht u asgjësua çdo varësi nga fuqitë imperialiste, u zhduk çdo lidhje e marrëdhënie skllavëruese me këto fuqi; populli shqiptar fitoi pavarësinë e plotë kombëtare; gjithashtu u përmbys sundimi politik i çifligarëve dhe i borgjezisë. Shqipëria u shkëput përgjithmonë nga sistemi kapitalist botëror.

Kjo ishte fitorja më e madhe e arritur nga populli shqiptar gjatë gjithë historisë së tij.

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare mbeti deri në fund një revolucion antiimperialist, demokratik. Por në gjirin e saj u zhvilluan edhe elemente të revolucionit socialist, si zhveshja e borgjezisë nga pushteti politik, vendosja e udhëheqjes së pandashme të Partisë Komuniste në pushtetin e ri etj. Kjo erdhi si pasojë e ashpërsimit të vazhdueshëm të luftës kundër klaseve kryesore shfrytëzuese të vendit dhe e gërshetimit të saj

me luftën kundër pushtuesve, gjë që e thelloi gjithnjë më shumë karakterin revolucionar të Luftës Nacionalçlirimtare.

Partia Komuniste nuk e nxiste ashpërsimin e luftës në mes klasave brenda vendit, nuk hodhi parulla për luftë kundër çifligarëve, bajraktarëve dhe borgjezisë; goditjen e saj kryesore e drejtoi deri në fund kundër pushtuesve fashistë. Luftën e klasës e ashpërsoi tradhtia e hapur e klasave shfrytëzuese.

Organizatrat politike, përfaqësuese të interesave të këtyre klasave, Balli Kombëtar, Legaliteti etj. u shkatërruan nga Ushtria Nacionalçlirimtare vetëm sepse u vunë në shërbim të pushtuesve fashistë. Me qëndrimin e tyre të hapur antikom-bëtar dhe antipopullor ish-klasat sunduese humbën çdo të drejtë për të pasur pjesë në pushtetin politik.

Pushteti i ri politik, që u vendos në Shqipëri pa mbaruar ende Lufta Nacionalçlirimtare, ndodhej krejt në duart e forcave revolucionare demokratike me Partinë Komuniste si udhëheqëse të vetme. Ky pushtet gjatë luftës nuk përbënte thjesht një diktaturë demokratike të forcave revolucionare, por një pushtet që përmbante në vetvete farën në zhvillim të shpejtë të diktaturës së proletariatit.

Me fitoren historike në Luftën Nacionalçlirimtare revolucionari ishte kryer vetëm në fushën politike. Problemet ekonomiko-shoqërore të revolucionit antiimperialist demokratik mbe-teshin për t'u zgjidhur pas lufte.

Forcat shoqërore lëvizëse kryesore në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare ishin klasa punëtore dhe fshatarësia e varfër me të mesmen. Morën pjesë gjithashtu në luftë borgjezia e vogël dhe e mesme e qytetit.

**Klasa punëtore luajti rolin udhëheqës në Luftën Nacionalçlirimtare. Këtë rol ajo e kreu nëpërmjet Partisë Komuniste të Shqipërisë.**

Klasa punëtore shqiptare ishte e vogël, e përndarë, e paformuar si proletariati industrial, por ajo që klasa më përparimtare që kishte të ardhmen përpara. Mbi të gjitha, asnjë klasë tjetër në vend nuk mundi të formonte një parti me një organizim të shëndoshë, me një politikë të drejtë të ndërtuar mbi themele shkencore, ashtu si e krijoi partinë e vet klasa punëtore.

Në organet drejtuese të Luftës Nacionalçlirimtare, si edhe në përbërjen e Partisë numri i punëtorëve ishte i paktë. Por kjo nuk e pengoi klasën punëtore të plotësonte rolin udhëheqës në këtë luftë. Partia Komuniste e Shqipërisë i edukoi anëtarët e vet, ndonëse shumë prej tyre vinin nga mikroburgjezia, sidomos nga shtresat e fshatarësisë, me një frymë të thellë proletare revolucionare, me një vendosmëri të rrallë për të mbrojtur interesat e proletariatit, të socializmit. Këto interesa në rrethanat konkrete shkriheshin në një të vetme me interesat e Luftës Nacionalçlirimtare, me interesat e mbarë popullit dhe të kombit shqiptar të robëruar.

**Fshatarësia u bë burimi dhe forca kryesore e armatosur e Luftës Nacionalçlirimtare, mbështetja më e shëndoshë e klasës punëtore dhe e Partisë Komuniste të Shqipërisë.**

Fshatarësia shqiptare përbënte shumicën dërrmuese të popullsisë. Ajo vërtet ishte e prapambetur nga pikëpamja ekonomike dhe kulturore, por ruante në gjirin e vet aftësi të mëdha revolucionare, të krijuara në luftën e vazhdueshme për liri e tokë, kundër shtypjes e shfrytëzimit të çifligarëve, kundër tregtarëve fajdexhinj, kundër regjimeve antipopullore të mëparshme, sidomos, kundër sundesve të huaj. Fshatarësia, më shumë se çdo klasë dhe shtresë tjetër në Shqipëri, ishte e pajisur me tradita patriotike luftarake të shëndosha. Duke marrë parasysh të gjitha këto, Partia Komuniste e vlerësoi shumë drejt rolin vendimtar të fshatarësisë në luftë. «Luftën do ta fitonte në kushtet e vendit tonë, — ka thënë shoku Enver Hoxha, — ajo klasë që do të kishte fshatarësinë me vete»<sup>1</sup>.

Fshatarësia pranoi programin dhe udhëheqjen e PKSH, pasi u bind nga përvoja e saj se kjo ishte e vetmja organizatë politike për luftë të vendosur kundër pushtuesve që i kthente fjalët në vepra, e zonja për të siguruar fitoren mbi pushtuesit fashistë dhe tradhtarët dhe për të plotësuar ëndrrat e fshatarit për liri e për tokë. Nën udhëheqjen e Partisë ajo tregoi patriotizëm dhe heroizëm të lartë.

Për gjithë periudhën e Luftës Nacionalçlirimtare Partia Komuniste mbajti parullën e mobilizimit të të gjithë fshatarësisë pa dallim klasor. Megjithatë, fshatarësia e pasur, paria

---

1 Enver Hoxha. Vepra, vëll. 17, f. 434.



fshatare, si klasë, nuk e pranoi programin dhe udhëheqjen e PKSH. Ajo, në përgjithësi, u lidh me organizatat tradhtarë të borgjezisë e të çifligarëve, me Ballin Kombëtar e Legalitetin dhe u bë mbështetja e tyre në fshat, duke shpresuar se kështu do të mund të ruante privilegjet e saj pas luftës.

**Borgjezia e vogël dhe borgjezia e mesme e qyteteve morën pjesë në Luftën Nacionalçlirimtare pa ndërmjetësinë e ndonjë partie të tyre politike,** ashtu si edhe fshatarësia. Ato nuk krijuan dhe nuk mund të krijojnë një parti politike të vetën, sepse ishin tepër heterogjene, të pafuqishme ekonomikisht e sidomos sepse u mungonte vendosmëria, pjekuria dhe përvoja në luftën politike. Për këtë arsye nuk kishin mundësi të luanin ndonjë rol udhëheqës në Luftën Nacionalçlirimtare. Ato pranuan programin e Partisë Komuniste, sepse panë që ky program shprehte edhe kërkesat e tyre të afërta politike.

Borgjezia e vogël, e cila përbënte shumicën dërrmuese të popullsisë së qyteteve, ndonëse nuk paraqitej shumë e vendosur dhe e gatshme për therori, u hodh pothuajse tërësisht në Luftën Nacionalçlirimtare dhe tregoi patriotizëm të shquar. Pjesa më e mirë e saj u lidh ngushtë me Partinë Komuniste.

Borgjezia e mesme shfaqti lëkundje të theksuara. Në radhët e saj dukeshin prirje për kompromis me pushtuesit. Por e gjendur nën darën e ligjeve të pushtimit, nën presionin e kapitalit të huaj dhe nën ndikimin e patriotizmit tradicional të popullit shqiptar, në shumicë u shpreh kundër robërimit dhe mori pjesë në luftën antifashiste, veçse nuk u tregua e gjallë. Vetëm një pjesë e vogël e saj mori anën e pushtuesve, duke u bashkuar me Ballin Kombëtar dhe me Legalitetin.

**Intelektualët shqiptarë,** shumica e të cilëve vinin nga shtresat e larta dhe të mesme të popullsisë, në përgjithësi u treguan patriotë dhe antifashistë. Pjesa më përparimtare e tyre u shqua për atdhedashuri, vendosmëri dhe frymë të thellë revolucionare, përqafoi vijën e Partisë Komuniste dhe luftoi për zbatimin e saj. Vetëm një numër i vogël intelektualësh, të brumosur me ideologjinë borgjeze fashiste, u bashkuan me pushtuesit. Ata shërbyen si ideologë të Ballit Kombëtar e të Legalitetit.

**Forca më e gjallë e Luftës Nacionalçlirimtare ishte rinia.** Ajo qëndronte në ballë të luftës kundër pushtuesve e tradhtarëve në qytet, në fshat dhe në Ushtrinë Popullore.

Shumica dërrmuese e rinisë u shqua për një ndjenjë të lartë patriotizmi e njëkohësisht për një frymë përparimtare thellësisht revolucionare. Ajo u lidh ngushtë me Partinë Komuniste dhe u bë luftëtare e flaktë për idetë e mëdha të marksizëm-leninizmit.

Më parë u hodh në luftën çlirimtare rinia e qytetit, punëtore e shkollore.

Rinia shkollore vinte kryesisht nga borgjezia e mesme dhe e vogël e qytetit. Krahas rinisë punëtore, duke milituar në radhët e Rinisë Komuniste, ajo dha një kontribut të rëndësishëm në propagandimin e vijës së PKSH në masat popullore. Në të njëjtën kohë, ajo shërbeu si një ndërmjetëse për të ushtruar ndikimin e Partisë mbi borgjezinë e vogël e të mesme të qytetit.

Por masën më të madhe të rinisë antifashiste e përbënte rinia fshatare, e cila pas rinisë së qytetit u hodh në luftë me një vrull dhe me një vendosmëri revolucionare të rrallë. Të rinjtë fshatarë bënë shumicën në Ushtrinë Nacionalçlirimtare.

**Një forcë e madhe e luftës antifashiste ishte gruaja shqiptare.** Ajo mori pjesë në këtë luftë në një shkallë të paparë në luftërat e mëparshme çlirimtare. Gratë shqiptare e përqaftuan vijën e Partisë Komuniste dhe luftuan me gjallëri për zbatimin e saj, përkrah burrave, sepse gjetën tek ajo jo vetëm rrugën e sigurt të çlirimit kombëtar e shoqëror të popullit, por edhe rrugën për të fituar të drejta të barabarta me burrat, për t'u çliruar nga çdo prangë e së kaluarës që i mbante skllave.

**Fitorja e madhe në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare u arrit në radhë të parë nga vetëmohimi dhe heroizmi i lartë që tregoi populli shqiptar në luftë.** Asnjëherë më parë ai nuk ka qenë kaq i bashkuar, kaq i vendosur dhe kaq i sigurt për fitoren sa në luftën kundër pushtuesve italianë e gjermanë dhe kundër tradhtarëve. Asnjëherë më parë ai nuk ka pasur një ndërgjegje kaq të thellë në qëllimin e luftës dhe nuk ka qenë kaq i gatshëm për çdo therori e privacion për hir të fitores.

Në Luftën Nacionalçlirimtare u shfaq me gjithë fuqinë krijimtaria e masave popullore në jetën politike dhe ushtarake të vendit. Në zjarrin e betejave të ashpra u treguan forca e pashtershme dhe aftësitë e mëdha të tyre. Nga mishi dhe gjaku i popullit, nga radhët e njerëzve të thjeshtë, të punë-

torëve, fshatarëve, intelektualëve patriotë dolën luftëtarë dhe udhëheqës të mrekullueshëm masash, komandantë e komisarë, anëtarë këshillash e ministra. Këta njerëz të popullit, shpesh pa arsim të mjaftueshëm, ua kaluan nga zotësitë dhe guximi dhe i mundën gjeneralët e oficerët me shkollë të armikut, politikanët profesionistë të regjimit të vjetër çifligaro-borgjez.

«Lufta jonë çlirimtare, — shkruante shoku Enver Hoxha në pragun e çlirimit, — e nxori popullin në krye dhe këtu e vetëm këtu qëndron arsyeja e fitores»<sup>1</sup>.

Me luftën heroike që bëri populli shqiptar çliroi edhe atdheun edhe veten e tij.

Një rol shumë të rëndësishëm për arritjen e fitores luajtën traditat e shkëlqyera patriotike e luftarake, përvoja e pasur që populli shqiptar pat fituar gjatë shekujve në luftërat e tij për liri e pavarësi dhe që në Luftën e fundit Nacionalçlirimtare i zhvilloi dhe i forcoi më tej.

**Frymëzuese, organizatore dhe udhëheqëse e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, farkëtuese e fitores ishte Partia Komuniste e Shqipërisë.**

Në luftërat e mëparshme çlirimtare populli shqiptar nuk kishte arritur të krijonte një udhëheqje monolite dhe konsekuente. Kjo ishte një arsye kryesore që ai nuk kishte mundur të fitonte më parë lirinë dhe pavarësinë e plotë dhe që frytet e përpjekjeve të tij të grabiteshin nga imperialistët, feudalët e borgjezia e vendit. Por nga luftërat, nga vuajtjet dhe mjerimi ai kishte nxjerrë një mësim të madh se pa një udhëheqje revolucionare gjaku dhe munda i tij nuk mund të kurorëzoheshin me fitore përfundimtare. Këtë ëndërr ai e realizoi me themelimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, të cilën e lindi, e rriti dhe e kaliti në luftë. Duke dalë nga gjiri i popullit shqiptar, kjo parti marksiste-leniniste trashëgoi prej tij tradita të shkëlqyera patriotike dhe një përvojë të pasur të luftës, diti t'i grumbullojë e t'i zhvillojë më tej këto tradita e këtë përvojë, t'u japë një përmbajtje të thellë revolucionare dhe t'i vërë në jetë për sigurimin e lirisë e pavarësisë kombëtare, për fitoren e revolucionit.

Partia Komuniste përpunoi dhe zbatoi me vazhdimësi, me vendosmëri dhe guxim revolucionar një politikë të drejtë, të

---

1 Enver Hoxha. Vendimet historike të Mbledhjes II të KANÇ, nëntor 1944. Vepra, vëll. 2, f. 375.

bazuar në parimet themelore marksiste-leniniste e në kushtet objektive të brendshme e të jashtme, politike që u përgjigjej drejtpërdrejt kërkesave të ngutshme politike, interesave rrënjësore të popullit, të atdheut dhe të socializmit.

Ishte Partia ajo që rrënjosi në masat e popullit një ndërgjegje aq të lartë në qëllimin e luftës dhe në drejtësinë e politikës së vet. Ishte Partia ajo që i zbuloi, i zhvilloi dhe i përdori në dobi të luftës kundër fashizmit të gjitha energjitë dhe aftësitë krijuese të masave popullore.

Masat u bindën nga vetë përvoja e tyre se Partia Komuniste ishte mbrojtësja e vërtetë e interesave të tyre e të kombit shqiptar, luftëtarja besnike dhe konsekuente për pavarësinë kombëtare, lirinë, demokracinë dhe tokën.

Partia Komuniste zgjidhi me mjeshtëri të rrallë tri detyrat çelës për sigurimin e fitores: bashkimin e masave të gjera në Frontin Nacionalçlirimtar, organizimin e kryengritjes së përgjithshme, armatosjen e popullit, krijimin e Ushtrisë së rregullt Nacionalçlirimtare, shkatërrimin e pushtetit të pushtuesve dhe të çifligarëve e të borgjezisë, organizimin dhe vendosjen e pushtetit të demokracisë popullore.

Partia i siguroi popullit shqiptar aleatë të jashtëm, të shumtë e të fuqishëm, dhe e edukoi atë me frymën e internacionalizmit proletar, të miqësisë dhe të vëllazërimit me të gjithë popujt që luftonin kundër fashizmit. Ajo zbatoi kundrejt aleatëve të jashtëm një politikë të drejtë, të ndërtuar mbi parime revolucionare. E mësoi popullin të bënte diferencimin në mes tyre dhe ta lidhte luftën e vet në radhë të parë me Luftën e madhe Patriotike të Bashkimit Sovjetik. Partia nuk lejoi asnjëherë që ndonjëri nga aleatët të ndërhynte në punët e brendshme politike dhe ushtarake të vendit. Ajo shkatërroi planin e reaksionit imperialist anglo-amerikan që u përpoq të ndalonte fitoren e revolucionit dhe të vendoste kontrollin e vet në Shqipëri. Duke mbajtur një qëndrim të çiltër ndaj aleatëve dhe duke vlerësuar drejt ndihmën dhe përkrahjen e jashtme, Partia nuk priti kurrë që lirinë t'ia sillnin të tjerët popullit shqiptar. Ajo zbatoi me vendosmëri parimin e mbështetjes në forcat e veta dhe e mësoi popullin ta kuptojë thellë se liria nuk dhurohet, por fitohet me gjak, me mundime e therori të shumta.

Partia Komuniste e Shqipërisë lindi, u rrit dhe u sprovua si udhëheqëse me zotësi dhe autoritet të pashoq në luftën revolucionare kundër pushtuesve e tradhtarëve. Ajo nuk priti të

mësonte më parë teorinë marksiste-leniniste pa të hidhej në luftë. Ajo e mësoi dhe e zbatoi njëkohësisht këtë teori me besnikëri e në mënyrë krijuese në zjarrin e luftës, në situatat e koklavitura.

**Faktori i jashtëm vendimtar i fitores historike të popullit shqiptar ishte Lufta e madhe Patriotike e Bashkimit Sovjetik dhe fitorja e tij e madhe mbi fashizmin, pavarësisht se Ushtria e Kuqe nuk erdhi në Shqipëri. Bashkimi Sovjetik nën udhëheqjen e J.V. Stalinit mbajti mbi shpatulla barrën më të rëndë në Luftën e Dytë Botërore dhe luajti rolin kryesor në shkatërrimin e fashizmit. Fitoret e Ushtrisë së Kuqe kundër Gjermanisë hitleriane krijuan kushte të përshtatshme që populli shqiptar të ngrihej i gjithë më këmbë dhe të siguronte me luftën e vet heroike pavarësinë e plotë kombëtare dhe vendosjen e pushtetit popullor.**